

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXIII i botimit, nr. 255, Janar 2025

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## 6 janar 2025 Homelia Mons. Angelo Massafra Arqipeshkev 2

Të nderuar Vëllezër në Episkopat Të nderuar Meshtarë, Të nderuar Regulltarë dhe Regulltare Të nderuar besimtarë të Arqidioqezës Shkodër-Pult! Kremtimi i sotëm më shoh që ta udhëheq për herë të fundit si Arqipeshkvi juaj, në ushtrimin e plotë të "munus sanctificandi"-t (pushtetin për të shenjtëruar), Eukaristinë e Shenjtë, vendin më të lartë të bashkimit me Hyjin dhe mes nesh. Zgjedhja e kësaj dite solemne për ta përshëndetur Dioqezën është për shkak të përvjetorit të njëzetetë të Shugurimit tim Ipeshkvnor, për të cilin dëshiroj ta falënderoj Zotin me gjithë zemër. Pjesa ungjillore e 10 të gërbulurve të shëruar na mëson rëndësinë e njohjes së të mirave që Zoti na jep dhe të falënderimit që i takon Atij. Kumtimi i Pashkës që dëgjuam pas Ungjillit na kujtoi se Zoti Jezus është qendra e gjithësisë: ai është "Zoti i kohës dhe i historisë" ...



## Grupi artistik, që e mbijetoi dhe e pasuroi tradiçen e kengës dhe vallës së krahinës së Dukagjinit

Grupi artistik "Treva" i zones së Dukagjinit mbushi 21 vjeç, me koncertin tradicional që dha mbremjen e së martës 17 dhjetor, në skenën e teatrit "Migjeni" Shkoder.

Njezerenje koncerte massive, per 21 vite me radhë, ku janë i interpretuar afro 700 kengë e valle të tradites së kësaj zone, por edhe të zonave të tjera nga Malësia e Madhe, Puka, Dha, Kukësi, Dibra, Kosova, ... 3

## KANUNI - DËSHMI E QENËSISHME E LIGJËSIVE TË LASHTA TË JETËSËS SË NJERIUT TONË 9

TRASHËGIMIA GOJORE: KOHËT E GJALLIMIT DHE KOHA E SHËNIMIT

Kurdo dhe në çfarëdo mënyre të flitet për trashëgiminë kulturore shpirtërore të një populli ose të popujve të ndryshëm, bartur gojarisht nëpër kohë, duhet të kihen parasysh, pos të tjerash, tri dukuri të rëndësishme: koha ose kohët e gjallimit (ekzistimit) të dukurive, koha e njohjes – e shënimit të tyre në formën e shkruar dhe fakti se ato nuk studiohen që të bëhen sot pjesë të jetës së përditshme, pa marrë parasysh rëndësinë e tyre, por që të njihen si pjesë e trashëgimisë që përligjin qenësinë dhe pasurinë kulturore dhe shpirtërore të popullit që i ka përdorur, aftësinë e individëve që i kanë përfutur ose i kanë bartur prej një brezi tek tjetri, duke i përshtatur sipas rrethanave dhe kushteve të jetës. Së këndejmi, edhe veprat letrare poetike të së kaluarës së largët, fjala, "Epin e Gilgameshit", "Iliadën", "Vedat" etj., nuk i lexojmë për arsye se ato dëshmojnë botëkuptimin tonë e të kohës sonë, po për artin e tyre që kushtëzuan pasurimin shpirtëror dhe artistik. Në këtë rrjedhë duhet parë edhe Kanunin e Lekë Dukagjinit, për të cilin bëhet fjalë në këtë parathënie, po dhe motërzimet (variantet), që janë bërë të njohura ose mund të zbulohen e të botohen.

## LETËRSIA GREKE NDERON PROF.DR.ZEF GJETËN PËR LIBRIN MË TË MIRË TË VITIT PËR SHTETASIT E HUAJ

Një vlerësim dhe nderim i veçantë është fitimi i çmimit të parë për librin "Pyetje të Çuditshme, Përgjigje Interesante" si libri më i mirë i huaj dhe përkthimi me i mirë i vitit 2024 në Greqi, ky çmim i fituar nga biri i Dukagjinit dhe i Shkodrës nderon edhe letërsinë shqiptare. Të flasësh për Prof.Dr.Zef Gjetën duhet një kohë e gjatë. Krijimtaria e tij është e shumtë dhe e larmishme. Përveç një specialist i mirëfillte i shkencës bujqësore në insitutin e Misrit dhe Orizit duke arritur rezultate shumë të larta në fushën e kerkimeve shkencore, ai në mesin e viteve 90' kur në Shkodër nuk botohej asnjë gazetë apo revistë, për vite me rrallë botoi gazetën e më pas revistën "Humori Shkodran" i cili pati jehonë nga lexuesit në të gjithë Shqipërinë. Zefi ishte ideatori dhe realizuesi i karnavaleve të para pas rënjes së sistemit monist në vitin 1998. Mbështetur nga një grup i përzgjedhur artistësh si organizator dhe regjizor i kësaj veprimtarie. Të flasësh për botimet e shumta në letërsi, publicistikë dhe në fushën akademike, si referate apo sesione shkencore, numri i referimeve 12 dhe jashtë është i palimituar...

## SHKELQËSIA JUAJ IMZOT ANGELO MASSAFRA!

Ju falenderoj në emë të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe krejt popullit të Dukagjinit, ku ju si Bari i mirë i fale popullit të besuar nga Selia e Shenjt, Dashuri dhe mbrojtje duke u lutur dhe ngritur Zërin në strukturat përkatëse, për të drejtat ligjitime. Kaluam kohë të vështira së bashku, por këshillat dhe shembulli juaj na ndihmuan shumë, për t’i përballuar ato. Të falenderoj, për lutjen dhe mbështetjen shpirtërore, që më dhurova. Porositemi në lutjen tënde dhe famleminderit! *Zoti ju bekoftë në rrugëtimin tuaj shpirtëror!*

# 6 janar 2025 Homelia Mons. Angelo Massafra Arqipeshkev

Të nderuar Vëllezër në Episkopat Të nderuar Meshtarë, Të nderuar Regulltarë dhe Regulltare Të nderuar besimtarë të Arqidioqezës Shkodër-Pult! Kremtimi i sotëm më sheh që ta udhëheq për herë të fundit si Arqipeshkvi juaj, në ushtrimin e plotë të “munus sanctificandi”-t (pushtetin për të shenjtëruar), Eukaristinë e Shenjtë, vendin më të lartë të bashkimit me Hyjin dhe mes nesh. Zgjedhja e kësaj dite solemne për ta përshëndetur Dioqezën është për shkak të përvjetorit të njëzetetë të Shugurimit tim Ipeshkvnor, për të cilin dëshiroj ta falënderoj Zotin me gjithë zemër. Pjesa ungujllore e 10 të gërbulurve të shëruar na mëson rëndësinë e njohjes së të mirave që Zoti na jep dhe të falënderimit që i takon Atij. Kuntimi i Pashkës që dëgjuam pas Ungjillit na kujtoi se Zoti Jezus është qendra e gjithësisë: ai është “Zoti i kohës dhe i historisë” dhe gjithçka duhet t’i referohet Atij. Pra, në Jezusin, unë e rilexoj shërbimin tim ipeshkvnor mes jush dhe e falënderoj Atë, ndërsa nuk mund të mos kujtoj me mirënjohjen dhe me dashurinë e një biri të dashur Shën Gjon Palin II, i cili i shtriu duart mbi mua 28 vjet më përpara. Për herë të fundit ushtroj edhe “munus docendi”-n (pushtetin për të mësuar) të ipeshkvit, duke “thyer” me ju “bukën” e Fjalës së Hyjit. Tregimi i Mateut ungujlltar për rrugëtimin e fesë që i çoi dijetarët në takim me Mbretin e porsalindur të Izraelit qëndron - siç ndodh shpesh në Ungjillin e tij - në konfirmimin e Besëlidhjes së Vjetër, duke parë në krejt zhvillimin e saj orientimin e padiskutueshëm drejt personit të Jezu Krishtit. Kështu, lehtësisht mund të shohim marrëdhënien me profecinë e Isaisë që dëgjuam në leximin e parë, ku mund të shohim, si të mbivendosura, figurat e Mesisë dhe të Jerusalemit-Izraelit drejt të cilëve krejt njerëzimi duhet të priret nëse dëshiron ta takojë Zotin e lavdisë. Nuk duhet të na çorientojë kjo mbivendosje e shumë figurave në planin e Hyjit, aq më tepër kur qëllimi i Isaisë profet është që t’i flasë Izraelit për ta bërë të vetëdijshëm për rolin e tij misionar në mesin e të gjithë popujve për t’i udhëhequr ata kah Hyji, ashtu si qëllimi i Mateut ungujlltar është që t’i flasë Kishës së të gjitha kohëve për ta bindur atë për të njëjtin identitet dhe mision. Jezu Krishti, na thotë Shën Pali në leximin e dytë, e vendos veten në qendër të këtyre dy periudhave të

një lëvizjeje të vetme të njerëzimit drejt Hyjit: “Njerëzit janë thirrur në Jezu Krishtin për të bashkëndarë të njëjtin trashëgimi, për të formuar të njëjtin trup dhe për të qenë pjesëmarrës të të njëjtit premtim nëpërmjet Ungjillit”. Atëherë, ky solemnit, ndërsa na bën ta soditim edhe një herë Misterin e Mishërimit të Birit të Hyjit, na jep një tjetër çelës leximi për ta

hës së Krishtlindjes. Pagëzimi, vëllezër e motra, na ka bërë “Krishta të tjerë”: si Krishti bij të Hyjit Atë, si Krishti gjymtyrë të trupit të Kishës së cilës Ai është kreu, si Krishti meshtarë për ta shenjtëruar botën dhe kohën në të cilën jetojmë, si Krishti jemi bërë mbretër për ta drejtuar veten tonë kah e mira dhe për të ndikuar mbi zgjedhjet shoqërore për të mirën e për-

është e gjallë? Një fe e vërtetë është një fe që nuk lodhet kurrë së kërkuari Hyjin në të gjitha situatat e jetës. Hyji është ai “yll” që kërkon të ndiqet; dhe rrugëtimi për ta ndjekur yllin është përshkuar dhe na është dhuruar neve nga Kisha: Fjala e Hyjit, Doktrina e Krishterë, Sakramentet, shenjat e kohës, fjalët e urta dhe këshillat e mira... e gjithë kjo na mundëson një ecje personale e bashkësiore kah Hyji. Mos i mungofshin kurrë Kishës sonë këto përkujdesje. Udhëzimin e dytë e gjejmë te “shtegtimi”. Tashmë kjo fjalë, falë Jubileut që po jetojmë, po hyn gjithnjë e më shumë në fjalorin tonë. Shtegtimi i njerëzve të urtë që shkojnë te Jezusi ka sjellë pasiguri, përvujtëri për të kërkuar pa pretenduar se dinë gjithçka (këtu qëndron urtia e vërtetë!), aftësi për t’i lexuar shenjat, vendosmëri dhe qëndrueshmëri në ecje, por sidomos fe dhe padyshim shpresë. Edhe ne, të dashur vëllezër e motra, jemi gjithmonë në ecje dhe si të tillë duhet t’i kalojmë të gjitha këto sprova dhe na kërkohen këto aftësi. Të mos e humbasim shpresën! Udhëzimi i tretë: “Të gëzuarit”. Ashtu si njerëzit e urtë u gëzuan kur panë yllin, ashtu edhe ata që bëjnë një ecje duhet ta bëjnë këtë me gëzimin e të pasurit gjithmonë para syve të tyre atë që i drejton. Nëse e humbasim qëllimin përfundimtar të jetës sonë humbasim edhe orientimin e rrezikojmë të humbasim në mijëra rrugë, të cilat nuk janë rruga kryesore. Sa vetë, për fat të keq, e humbasim rrugën duke e lënë veten që të pengohen nga gjërat e botës... pavarësisht Pagëzimit që kanë marrë! Por edhe në këtë gjë bashkësia e krishterë duhet ta pyesë veten: çfarë duhet të bëjmë për të mos lejuar që vëllezërit dhe motrat tona më të dobëta të humbasin? Udhëzimi i katërt qëndron tek qëllimi: “adhurimi”. Ky është qëllimi përfundimtar. Por të mos e mendojmë vetëm si një pikë mbërritjeje në fund të shtegtimit tonë: kërkimi, ecja e adhurimi janë elemente të përditshme për të krishterët; çdo ditë përbëhet nga rritja e fesë, nga tejkalimi i vështirësive (sidomos i egoizmit që na mbyll) dhe nga adhurimi. Prandaj, të adhurosh do të thotë ta njohësh personalisht dhe nëpërmjet përvojës misterin e Hyjit. Vëllezër dhe motra, po ju lë këtë mësim të fundit të Ungjillit si trashëgimi timen: jini një Kishë e vetëdijshme për thirrjen e saj për ta mishëruar Krishtin në kohën e tanishme dhe për misionin e saj



kuptuar këtë mister: “shfaqja (kështu do të thotë fjala “epifani”) e Birit të Hyjit” nuk është vetëm e rëndësishme në vetvete, por është e rëndësishme edhe për identitetin tonë si Kishë, si popull i ri i Hyjit. Prerogativat e Izraelit të lashtë, falë Jezu Krishtit, janë bërë edhe prerogativat tona: domethënë jemi të thirrur për të qenë misionarë mes të gjithë njerëzve; jemi të thirrur që të jemi, si Kishë, mjete nëpërmjet të cilit secili mund të arrijë te Hyji. Me të drejtë në këtë ditë simboli i ujit të shenjtë ka një rëndësi të madhe; por duhet të pastrohet që të mos kuptohet vetëm në kuptimin e devotshëm, por më tepër në kuptimin e vet të vërtetë: një lidhje e thellë me pagëzimin që kemi marrë dhe që edhe një herë do të kujtohet nga liturgjia e dielës së ardhshme, në përfundim të Ko-

bashkët, dhe si Krishti jemi profetë për t’ua kumtuar të gjithëve Ungjillin e shpëtimit. Kjo është detyra e çdo të pagëzuarit! Por, duke vazhduar të meditojmë mbi Ungjillin që dëgjuam, mund të shohim edhe elemente të tjerë që na ndihmojnë të kuptojmë se ku t’i vëmë themelet e të qenit tonë misionarë. Në fakt, nuk mjafton që të kemi një vetëdije teologjike për pagëzimin që na ka bërë misionarë për nga natyra (e dimë se mes të thënit dhe të bërit shpesh lindin pengesa që e vënë në vështirësi të qenit tonë të krishterë); nevojitet diçka tjetër: nevojitet “urtia e veprave”. Le ta mësojmë atë nga njerëzit e urtë të Ungjillit. Ata na ofrojnë disa udhëzime të vlefshme. Udhëzimi i parë është “kërkimi”. A mund ta quajmë veten vërtetë të krishterë nëse feja jonë nuk

për t'i çuar të gjithë njerëzit tek Ai; por pa mendjemadhësinë e superioritetit, por me përvujtërinë dhe urtinë e atyre që e dinë se janë mes bashkëkohësve të tyre si "shtegtarë" gjithmonë në kërkim, të gëzuar në shpresë, asnjëherë të ngopur me njohjen e Hyjit duke e adhuruar atë. "Munus"-i tjetër i ipeshkvit është "munus regendi" (pushteti për të qeverisur): ia besoj me shumë besim pasardhësit tim të nderuar në katedrën e Shkodër-Pultit, Imzot Giovanni Peragine-s, të cilit i shpreh gjithë vlerësimin tim dhe i bëj uringet e mia më të sinqerta për një shërbim të frytshëm mes jush. Po e mbyll duke falenderuar jo vetëm Hyjin, por edhe të gjithë ju pa u futur në detaje për të mos lënë askënd jashtë: fytyrat tuaja janë të dashura për mua dhe mbeten të pashlyeshme në kujtesën time; si ata që më shoqëruan në shërbim, ashtu edhe ata që e panë të arsyeshme të mos e bëjnë atë. Kërkoj falje nëse kam bërë keq ndonjë gjë dhe fal me gjithë zemër, sipas mësimin të Mësuesit dhe Zotit tim Jezu Krishtit. Po kthehem në tokën time të origjinës dhe në Urdhrin e Fretërve Minorë, që më dërgoi mes jush si misionar. Po ju lë me fjalët e atit tim Shën Françesku. Në fund të jetës së tij, pasi realizoi të gjitha të mirat për të cilat ishte i aftë, iu drejtua vëllezërve të tij me këto fjalë: "Të fillojmë, o vëllezër, që t'i shërbejmë Zotit Hyj, sepse deri tani kemi bërë pak ose aspak!". Dhe përsëri u tha fretërve: "Unë e bëra detyrën time; përse u përket juve, Krishti jua mësoftë atë!". Atij i qoftë nderi, fuqia dhe lavdia në shekuj të shekujve

Shkelqësia juaj Imzot Giovanni Peragine! Në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe krejt popullit të Dukagjinit, ku ju jeni emëruar "Bari i Mirë" Arqipeshkvi i Arqidioqezës Shkodër-Pult, për ne nga Ati I Shenjtë- Papa Françesku. Ju urojm mirë se ardhjen në mesin tonë dhe porositemi në lutjen dhe përkujdesjen tënde atërore.

### Mesazh i drejtuar Arqidioqezës

Të dashur vëllezër e motra,

me pranimin nga Papa Françesku të dorëheqjes së paraqitur nga Imzot Angelo Massafra për arsye të plotësimit të kufirit të moshës, sipas dispozitave kanonike, po përgatitem të filloj shërbesën time si bari i Arqidioqezës Shkodër-Pult.

Jam i vetëdijshëm se jam pjesë e një historie të pasur dhe të një rrugëtimi të frytshëm të nisur nga paraardhësit e mi. Mendimet e mia shkojnë te Arqipeshkvi i parë i kësaj Kise, menjëherë pas rënies së regjimit, Imzot Frano Illia, gjithashtu famullitar i Milotit për shumë vite, ashtu si edhe unë, dhe mbi të gjitha te Imzot Angelo Massafra, i cili me vendosmëri dhe mençuri baritore, arriti ta drejtonte këtë Arqidioqezë në vitet e rilindjes së saj, deri më sot.

Që nga momenti i emërimit tim si Arqipeshkëv Koadiutor, më 20 maj 2024, me mendimin se duhej t'i shërbeja kësaj Arqidioqeze, më erdhi menjëherë në mendje episodi biblik i thirrjes së Moisiut, i cili tregohet në librin e Daljes (3,1-5). Moisiu, tashmë në moshë, ndërsa kulloste grigjën e tij, u gjend në malin Horeb, ku pa një kaçubë që ndizej flakë, por që nuk digjej; duke iu afruar asaj, dëgjoi zërin e Zotit që e thërriste nga kaçuba.

Ndërsa meditoj mbi këtë fragment biblik, thirrja e Zotit ripërtërihet në mua

dhe, që nga dita e pagëzimit tim, vazhdon të rrezatojë në zemrën time, duke ngjallur *habi dhe frikë*. Edhe një herë kuptova se Zoti më thërret dhe më kërkon që ta ripërtërij "Po-në" time: të them edhe një herë "ja ku jam", të lë gjithçka e ta ndjek në një rrugë të re jete dhe shërbimi që Ai vetë do të ma tregojë.

Ndjenja e habisë që ndiej për atë që Zoti, nëpërmjet Kishës, po më kërkon, më jep zemër që t'i besoj vullnetit të tij dhe ta pranoj atë që është e re. Në të njëjtën kohë, nuk e fsheh *frikën* time përballë kësaj thirrjeje. Jam i vetëdijshëm që po hyj në një Kishë me traditë të lashtë të krishterë, një Kishë të pasur me një visar fetar dhe kulturor që ka mundur ta ruajë e ta mbrojë edhe në kohë tejet të vështira.

Me ardhjen në këtë Arqidioqezë jam i vetëdijshëm se po shkel në një "tokë të shenjtë", një tokë e larë me gjakun e shumë martirëve, të cilët, për të dëshmuar besnikërinë e tyre ndaj Krishtit e për të treguar afërsinë e tyre me njerëzit, nuk ngurruan të japin edhe jetën, si Krishti.

Të dashur, jam i bindur se edhe sot ka shumë njerëz dhe shumë realitete që vazhdojnë ta bekojnë këtë tokë, duke e bërë të "shenjtë".

Janë besimtarët e shumtë të pranishëm në qytet, në periferi e në male, të cilët,

nevojë, por edhe të rinjtë e shumtë që janë të përkushtuar për të investuar për të ardhmen në Shqipëri edhe pse duket gjithnjë më e pasigurt.

Janë njerëzit që me angazhimin e tyre social luftojnë për një vend më të mirë, janë familjet që edukojnë fëmijët e tyre me shumë sakrificë.

Janë gjithashtu priftërinjtë, bashkësitë rregulare dhe misionarët, të pranishëm në të gjithë territorin e dioqezës, që çdo ditë ofrojnë shërbimin e tyre në fushën shpirtërore, arsimore, shëndetësore, kulturore dhe bamirësisë.

Së fundi, janë njerëzit e shumtë të cilët, pavarësisht se u përkasin traditave të ndryshme fetare, kontribuojnë për ta bërë këtë tokë të bukur përmes dialogut, bashkëpunimit dhe respektit të ndërsjellë.

Janë të gjithë shembuj njerëzish të virtytshëm që lindin mirësi e bukuri e që kundërshtojnë me forcë atë mentalitet korruptiv që, përkundrazi, i shpërftyron, i shëmton dhe pengon zhvillimin autentik e të qëndrueshëm të vendit.

I vetëdijshëm për kufijtë e mi, unë hyj në këtë tokë me "këmbë të zbutura", duke u dorëzuar plotësisht në duart e Atij që më thirri e që do të më japë gjithçka që nevojitet për ushtrimin e shërbimit tim në mesin tuaj.



nëpërmjet dëgjimit të Fjalës dhe kremtimit të sakramenteve, kultivojnë arsyet e fesë dhe shpresës, duke vazhduar të bekojnë këtë tokë.

Janë të moshuarit dhe njerëzit e shumtë të vetmuar që luten pandërprerë, janë të sëmuret e pranishëm në çdo shtëpi, pa ndihmën e duhur, ata që ofrojnë vuajtjet e tyre për të mirën e Kishës.

Janë gratë dhe burrat vullnetmirë, të cilët, përmes vullnetarizmit dhe solidaritetit, përpiqen që t'i lehtësojnë vështirësitë e atyre që kanë më shumë

Nëse do të mund ta përmbledhja me një fjalë të vetme dëshirën që mbaj në zemër duke hyrë në këtë Dioqezë të bukur, ajo është "bashkimi". Kisha është bashkësi dhe e merr këtë thelb nga dashuria trinitare që e formëson dhe e përsos vazhdimisht. Koncili II i Vatikanit thotë se Ipeshkvi është parimi i dukshëm dhe themeli i këtij bashkimi në Kishën vendore që i është besuar (LG 22).

Si pasardhës i Apostujve, jam i dërguar nga Provania hyjnore për ta bërë të pranishëm, mes jush, Jezusin, Kryet, Bariun,

Shërbëtorin dhe Dhëndrin: ju, si bashkësi e besimtarëve, me anë të pagëzimit, më jeni dhënë mua si bij që ia kthejnë Atij dashurinë që kanë marrë; Shpirti i Shenjtë, duke na bashkuar në lidhjen e dashurisë reciproke, na bën të gjithëve, edhe pse shumë, një "një trup" të vetëm (1 Kor 12:27).

Në ndryshmërinë e thirrjeve, shërbësive dhe karizmave, të gjithë ne formojmë një familje të vetme të Zotit në një dhurim reciprok: unë me ju për të shprehur shërbesën time ipeshkvoe me vërtetësi dhe frytshmëri apostolike, ju me mua për të qenë plotësisht dhe besnikërisht Kisha. Unë vij mes jush si atë për të qenë vëlla me ju dhe t'ju shërbej si bijve.

Për t'u rritur në këtë bashkësi vëllezërore, ndiej dëshirën t'ju takoj të gjithëve dhe të vihem në një qëndrim dëgjimi, në mënyrë që, me përfshirjen e priftërinjve, rregulltarëve, rregulltareve e të laikëve, të fillojmë së bashku për të menduar fazat e rrugëtimit tonë baritor për të qenë Kisha e Krishtit në këtë kohë e në këtë vend.

Dialogu me të gjitha realitetet të tjera jo katolike të pranishme në dioqezë do të jetë gjithashtu i rëndësishëm. Mendoj për besimtarët e Kishës ortodokse dhe të besimeve të tjera të krishtera, për vëllezërit tanë myslimanë dhe për autoritetet civile, të cilët së bashku me të gjithë njerëzit vullnetmirë punojnë për të mirën e qytetarëve dhe mbrojtjen e dinjitetit të çdo njeriu.

Përballë thirrjes së tij, Moisiu shfaq njëfarë ndjenje papërshtatshmërie për misionin që i është besuar, por është vetë Zoti që e përforcon disa herë, duke ia garantuar praninë e vet. Në ndërhyrjet e tij, Zoti na bën të kuptojmë se autori i misionit kishtar dhe i çdo veprimi baritor është vetë Ai. Protagonisti i Kishës është Shpirti i Shenjtë, ndërsa ne jemi vetëm vegla në duart e tij, të thirrur për t'i besuar fjalëve të tij: "Mos ki frikë, unë do të jem me ty".

Fillimi i shërbesës sime të re mes jush përkon me hapat e parë të rrugëtimit jubilar. Së bashku do të bëhemi "shtegtarë të shpresës" për ta pritur me mahnitje të përtërirë dashurinë e mëshirshme të Hyjit, për të rifituar gëzimin e të qenit dishepuj misionarë të Jezusit dhe për të planifikuar së bashku rrugëtimin e ardhshëm të Kishës sonë.

Ia besoj Zotit personin tim dhe shërbesën time ipeshkvoe në këtë Arqidioqezë, duke kërkuar menjëherë ndërmjetësimin e Marisë tejet të Shenjtë të Këshillit të Mirë dhe të lumëve Martirë Shqiptarë.

Lutuni për mua, për Kishën tonë në Shqipëri dhe për atë që, falë punës së misionarëve, arrin "skajet e botës" (Vap 1,8).

Shkodër më 8 janar 2025

+Imzot Giovanni Peragine  
Arqipeshkëvi juaj

Të nderuar anëtare e anëtarë të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Të nderuar miq të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Të nderuar dukagjinas kudo ndodheni! Në këtë vit, me mjaft realizime, kemi pasur dhe ndarje nga jeta të bashkëpunëtorëve të SHAD, madje bashkëthemeluesit e drejtues të saj: ishin shokë e bashkëpunëtor të mirë, që gjatë do të kujtohen për përkushtimin e tyre në realizimin e misionit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"! Ngushëllojmë familjet e tyre, qofshin e ti kujtojnë! I paharruar kujtimi I Fran Vuksanit, Voc Dedes, Luigj Shytit, Pjeter Geres e Ndue Micit!



Fran Vuksani,  
me 16 prill 2024



Voc Dedë Mjetaj,  
me 12 gusht 2024



Luigj Shyti,  
me 20 tetor 2024



Pjetër Fran Geraj,  
me 29 tetor 2024



Ndue Mici,  
me 26 nëntor 2024

# Grupi artistik, që e mbijetoi dhe e pasuroi traditën e këngës dhe vallës së krahinës së Dukagjinit

Grupi artistik "Treva" i zones së Dukagjinit mbushi 21 vjeç, me koncertin tradicional që dha mbremjen e së martës 17 dhjetor, në skenën e teatrit "Migjeni" Shkoder.

Njezereje koncerte massive, për 21 vite me radhë, ku janë interpretuar afro 700 këngë e valle të traditës së kësaj zone, por edhe të zonave të tjera nga Malësia e Madhe, Puka, Lezha, Kukësi, Dibra, Kosova, Plavë - Guci - Rozhaje - Tuz e deri në Ulqin.

"Treva" u krijua për të trashëguar e kultivuar këngën e vallen e krahinës së Dukagjinit, që rrezikoheshin nga shpopullimi masiv gjatë viteve të tranzicionit si në të gjitha zonat e tjera malore të vëndit tonë, dhe ia arriti qëllimit! Sot pas 21 viteve, themeluesit dhe drejtuesit e këtij grupi, Fran Kodra dhe Ndue Shytani, ndihen krenar për arritjen e shënuar që kënga dhe vallja e Dukagjinit jo vetëm mbijetoi por edhe u pasururua me krijimtari e interpretime të reja mbi bazë e kësaj traditës së trashëguar ndër breza! Vetëm në skenat e shfaqjeve, 21 koncertet tradicionale të "Treves" ku janë agazhuar mbi 1200 këngëtarë, instrumentistë, vallëtarë e humoristë, janë ndjekur nga rreth 20 mijë artëdashës, nderkohë që e gjitha kjo pasuri artistike është e sistemuar edhe në rrjetet sociale. Meritojnë mirënjohje të gjithë,



nga bashkëthemeluesi i këtij grupi, i ndjeri Mëhill Çuni, ndër këngëtarët në të spikatur të veriut të Shqipërisë, dhe deri tek artistët vegjël 10-12 vjeçar

që iu bashkuan të rriturve sonte në skenën e teatrit "Migjeni"! (Rënditja e fotove në vijim është bërë thjeshtë sipas memorizimi në celular, pa ndonjë

përzgjedhje).

REDAKSIA

“Sofra e Dukagjinit” u zhvillua për vitin e tetë rradhazi zhvillon veprimtrinë e saj në ambjentet e Bar Restorant “Antika”.

# “Sofra e Dukagjinit” në Londër

“Sofra e Dukagjinit” në Londër me 1 dhjetor 2024, një mikpritje e shkëlqyer, një preformancë e bukur artistike.

Kjo sofër tradicionale festive dhe folklorike është institucion për të ruajtur kulturën, traditën dhe historinë tonë

Faleminderit vëllezër dhe motra Dukagjinas për bujarinë dhe respektin e treguar ndër vite ndaj nesh, Ju jeni frymzimi dhe suporti më i mirë i krijimeve tona muzikore folklorike.

Faleminderit kolegeve këngëtarë për këtë preformancë të shkëlqyer. Faleminderit stafit që na mbështeti në realizimin e projektit tone.

Grupi drejtues i Shoqatës “Sofra e Dukagjinit”, ju shpreh Mirënjohje dhe ju uron Gëzuar festat e fundvitit..

“Sofra e Dukagjinit” si një nga veprimtaritë më të rëndësishme të muzikës folklorike, u mbajt me datën 28 Dhjetor, si gjithmonë, në ambjentet e Bar restorant Antika, Shkodër.

Por tashmë “Sofra e Dukagjinit” i ka shtrirë kufijtë e saj edhe më gjërë, për të dytin vit rradhazi mbahet në Londër me datë u mbajt më 30 nëntor, në adresën: “Royal Tirana Venue”, 1A Jute Ln, London, Enfield EN3 7PJ.

Ndërsa risi për këtë vit ishte Italia, ku për herë të parë u mbajt “Sofra e Dukagjinit, Firenze 2025”, më 7 Dhjetor 2025, në restorantin “La Selva”, me adresë Via Di Barberino 221, Calenzano, Firenze.

Qëllimi kryesor i këtyre veprimtarive vazhdon të mbetet të ruajë dhe promovojë traditat shqiptare, duke krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe mikpritëse për të gjithë Shqiptarët kudo ku ndodhen dhe të gjithë ata që kanë interes për kulturën tonë. Emri “Sofra e Dukagjinit” lidhet me traditat e lashta të mikpritjes dhe bujarisë që janë të rrënjosura thellë në kulturën shqiptare, sidomos në zonat tona.

Sofra e Dukagjinit është shumë më tepër se një mbledhje festive, Emri “Sofra e Dukagjinit” lidhet me traditat e lashta të mikpritjes dhe bujarisë që janë të rrënjosura thellë në kulturën tonë, sidomos në zonën e Dukagjinit. Ajo shërben si një platformë për të ruajtur identitetin kulturor tonin. E sidomos për shqiptarët që jetojnë jashtë vendit, në Londër dhe Firenze e kanë prituri me padurim, duke e konsideruar si një pikë lidhjeje me kulturën dhe historinë tonë të pasur, një aktivitet i

tillë ndihmon në forcimin e lidhjeve me atdheun, më Dukagjinin, dhe krijimin e një ndjenje përkatësie, së ju nuk mund të vini në Shqipëri, e sofrën ktu, por vjen sofra tek ju, si gjithmonë më president z. Vuksan Xhuri, Drejtues organizativ. z. Marjan Ndershtiqaj, dhe drejtues artistik z. Lulash Brigja.

Mbështetësit ishin të shumtë edhe në “Sofrën e Dukagjinit” në Shkodër, duke i falenderuar secilin për vlerësimin që i bën sofrën ndër vite që janë:

Sofra e Dukagjinit mbetet një dëshmi e gjallë e trashëgimisë kulturore dhe shpirtit të bashkimit të shqiptarëve. Përmes këngës, valleve dhe shijeve të traditës, ajo rikthen vlerat e autencitetit dhe krenarisë kombëtare, duke i kaluar nga një brez në tjetrin. Ky aktivitet nuk është vetëm një festë, por një kujtesë e rrënjëve tona dhe një thirrje për të ruajtur e promovuar identitetin tonë të pasur kulturor. Në çdo sofra të tillë, Dukagjini jo vetëm që tregon historinë e tij, por frymëzon të gjithë shqiptarët të vlerësojnë dhe të festojnë atë që na bën unikë.

Sofra e Dukagjinit mbetet një nga manifestimet më autentike të trashëgimisë sonë kulturore, duke sjellë në vë-

mendje vlerat e pasura të traditës dhe shpirtit të bashkimit kombëtar. Përmes këngëve të lashta, valleve dinamike dhe shijeve unike të kuzhinës shqiptare, ajo ruan e rikthen kujtimet e një jete plot harmoni dhe lidhje të forta mes njerëzve. Sofra nuk është vetëm një mbrëmje festive, por një urë mes së shkuarës dhe së tashmes, një thirrje për t’u kthyer tek rrënjët tona dhe për t’i ruajtur ato me krenari. Çdo sofra e tillë është një përvojë që pasuron shpirtin, forcon identitetin kombëtar dhe na kujton vlerat e mikpritjes dhe bujarisë që na karakterizojnë si popull. Në këtë atmosferë të ngrohtë, Dukagjini nuk tregon vetëm historinë e tij, por frymëzon brezat e rinj për të vazhduar traditat dhe për të qenë mbrojtës të kulturës sonë. Kjo është fuqia e sofrës – një festë që lidh të kaluarën me të ardhmen, duke na bërë të ndjehmë thellë atë që na bën unikë.

Mbështetësit ishin të shumtë edhe në “Sofrën e Dukagjinit” në Shkodër, duke i falenderuar secilin për vlerësimin që i bën sofrën ndër vite.

**Klodjana Serraj**



# SI E NJOHA PREKË NDOKË QETEN

Prekë Ndokën Qetën dhe brezin e tij do ishte marrëzi të them se nuk i njoha emër, për emër. Gjithsesi me sinqeritet dhe pa asnjë mos përfillje, them se nuk arrita t'i njohë të gjithë pasi nuk pata rast të punoja ose të rrija gjatë me secilin ndër kohë që vetëm kështu ke rast të përfitosh një njohje të plotë... Prekë Ndoka la gjurmë në qenien time që kur isha krejt i vogël. Jemi takuar rrugës nga shkollimi ose kthehemi në shkollë, ndërsa ai vinte nga Blini skajore në qendër të Shoshit. Nuk më thërriste Prelë por Prelush! Nuk e mohoj se me respektonte më shumë se të tjerët, por ai i pyeste të gjithë çika e djem me dashamirësi. Ja fillonte me urimin ju ruajt Zoti! Djem e çika boll të mirë këneni secili! A u lodhet, a mësuar? Qebesa po mësuar mirë edhe fort më të mirë bëheni! Pastaj na pyeste për prindërit emër për emër. Si janë a po lodhën si kanë bereqetet?! Ma jep çantën se ta mbajë,- i thoshte më të vegjëleve zakonisht atyre te klase se parë. Ne atë kohë çanta e librat peshonin goxha. Qëllonte që kishte me vete ndonjë strajce dhe na jepte arra apo gështenjash dhe nuk linte asnjë pa gjë. Gjatë gjithë rrugës gjente fjalë mbas fjale të këndshme për moshën tonë krejt ndrysh nga disa te tjerë që sillshin më të ftohtë apo autoritare me ne. Më kujtohet një rast kur po këndonin dy vajza te klasës se shtatë e gjashtë Lula Fiku dhe Marie Sukani. Lula kish një vokal shumë të mirë ajo ishte jo vetëm pjesëtare grucit artistik të shkollës, por e kish ftuar edhe shtëpia e kulturës. Po këndonin këngën "Në Kodër të Kuqe tre luan". "Kodër e kuqe" quhet edhe një kodër pak pa dalë përkundra Qytetzës (Pepsumajve). Thiret kështu për shkak se ishte dhekuqe. Shoqet tona kur ktheheshin nga shkolla ia thoshin kësaj këngë shpesh madje më zë të thekshim. Mos gabofsha ka qene dita e Shën Mëhillit të vitit 1977, vajzat po këndonin, kur krejt pa prituri pa u shfaq Preka që vinte nga pas kodrës. Si gramafoni kur fikën dritat vajzat e ndërprejnë këngën dhe ulen kryet si trandafila të skuqura O lumtu goja çoka të mira! Pasha bukën ma mirë se Fatime Sokoli e Drande Gega po këndonin i uroj Preka. Mos u skuqini se nuk po banit as të keqe Këngën që keni mësue në shkollë po këndonin. Oj çika e kumbarës i ; -tha Lulës hajde ta këndojnë bashkë! Lula pak e stepur u afrua por këngës nuk po i'a nisete. I vinte zori. Ham drejt pushkë po këndojmë e po na ndihmon edhe çika Zefit Marshit. Maria u ba edhe ma spec në fytyrë. Më cofte mushka po nuk kënduat! Kjo shprehje i bani vajzat të çemocionoheshin dhe ja nisën trio këngës duke theksuar fort refrenin- "Na u vra tarzani burra /Vojo partizani/Hakun se lamë pa ja marre! Më vonë kur u rrita te Preka hetova këngëtarin dhe instrumentistin emirë inopozant, të lahutës dhe çiftelisë që nuk merrte poza rabsodi ndonëse ishte kishte të gjitha hiret e një këngëtarit më zë ëmbël. Preka në përbërje te Ansambllit Folklorik të Shkodres çoj për herë të parë në Gjro-kastër "Gjamën e burrave te Dukagjinit." Në male tona lahuta kishte vendin në

ballë të oxhakut, pa pushkë. lahutë dhe trevesë nuk të ka thanë kush shpi e mirë. Preka Ndoka këto i trashëgoi dhe nuk i mori hua, por edhe i çoj më lart. Lindi në Pylaj të Shoshit, në kullën e Mic Sokol Delise<sup>1</sup> por vjeshtonte e dimëronte në Blini sipër një vau me ujë të kaltëruar si qelli. Pak me JP kufizohej me Komlemin fortesën historike te Shoshit të ngujuar në një shatrrëhim të gjatë me 1761 nga osmanet<sup>2</sup>. Ngjitur me Blinin shtrihej Guri i Lekës fshat emblematik që i lidhet me Lekë Dukagjinit "Leka kish pas lanë roje për me kundrue kur të binte qytetin e Dakajve në dorë turkut.<sup>3</sup> Prej këtu Lekë Dukagjini i lëshoi nëmën e famshme turkut "Asnjë mos i gëzofte deri sa të vijë i zoti i trojeve në vendin e vet"<sup>4</sup> Heroi epik Fishtës Sokol Tona që atlash i fisit te tij<sup>5</sup>, ndërsa Preka që i vogël u ushqye me epusin tij, të Ndoc Dedës dhe Bush Delisë që përbejë triumviratin e madh trimëror të Gurit të Lekës llagëpin e te cilit trashëgoi edhe Kolë Gurashi (Nika)<sup>6</sup> babai i këngës popullore shkodrane. Prekë Ndokën Qeten e njoha si burrë me konstrukt të shkëlqyer fizik, gjoks trapez shtatull gjere me muskuj të harlisur flokë gështenje të qethur shkurt te krehur mirë, fytyrë qeshur sy të zgjuar dhe të menduar. Njeri i fuqishëm që rrezatonte mirësi e butësi dhe nuk demonstronte kurrfarë superioriteti apo agresivitet fizik ndaj askujt veç në rast se ndokush tejkalonte çdo limit. Punëmirë si blea i pa lodhur si ka, puna kurrë se tuti, puna për të ishte mjeshtri dhe argëtohej duke punuar. Puna i pati berqet, gjithmonë që tregonin kotecat e drithit plot, ara, kopshiti vreshti bashtina që lulëzonin veç të tjerëve. Homallat kashnjeti livadhi të stolisur si kartolinë, gavixhat e rrushit plot e përplot, vozgat varg me raki e venë ku ishte ma mira ndër male. Shekat e djathit, kosit të kulluar, qypat e mjaltit e të tlyenit ku asnjë herë nuk herrej të vjetrit pa e ra i riu. Shtëpia 20 pash e gjate, jerevia përkrah, mokra, pak më lart mullini mushku, qete pendë larukat, murrikat

<sup>1</sup> Prekë Ndokë Qeta ishte Nipi i Mic Sokol Delisë, (vëllait të fatosit të flijuar në Kryengritje e Malësisë se Madhe të vitit 1911. Në afërsi të Virit të Kastratit një numër i vogël shaljanësh e shoshianësh po mbanin të tmerruar një trupe bashibozukësh. Këta ndodheshin në një pozicion më të ultë kurse kryengritësit ishin aftuar një shkëmbi që ngrihej sipër tyre bënë kërdinë mbi ta. Një farë bush delia prej Shoshit, një trim i dëgjuar, me gjoks jashtë, u dha në majën e shkëmbit e sipër tyre si një skifter dhe duke qëlluar sa mundi mbi ketë turmë fatkeqes, u thërriste me sa kishte në kokë "Hidhuni në ujë po të doni të shpëtoni". Një njeri i pranishëm më, tha se plumbat bini si kokra breshërit... Pasi e mbushi maunxerën me fishekë shpejt e shpejt luftëtarit hodhi një sy mbi ketë turmë të tmerruar, kur një plumb e mori tej për tej.. Këtu mbetën të plagosur Sadik Rama të bijtë e Marsh Pjetrit e të Dak Kolës prej Gimajve të Dukagjinit. Nga turqit një pjesë e mirë mbetën te vranë në vend, kurse te tjerët ja mbathën vrapit (Kamilio Libardi Lëvizjet e para Patriotike 1910/1911/1912, fq 315.)

<sup>2</sup> Misionarët Françeskan në dioqezën e Pultit dhe djegia e Shoshit" është njeri nga dhjetë kapitujt e librit "Kontribute per historinë Kishtare të Shqipërisë së Epërme te shek 17-19 të historianit arbëresh Italo Sarro. Studimi i tij është një përmbledhje koncize e Relacioneve në Arkivin e Propogandes Fide në Vatikan.

<sup>3</sup> Zef Arapi "Dukagjini në dokumente historike". AM-HSH f.q 123 i dorëshkrimit daktilografik

<sup>4</sup> At'. Benardin Palaj H. Dritës 12-12 1941

<sup>5</sup> Ndoke Mici ishte babai i Prekës shtëpiar i kamur i rangut parë në Shosh, besnik tërvestarë gaztorë antifashist dhe punëtorë i pa lodhur.

<sup>6</sup> R. Prenushi."Jete e pasur në shërbim të këngës popullore shkodrane"Jeta e Re 6 gusht 1988.

dhe kuqeshat<sup>7</sup> qime shkëlqyese. Shy-tat e sqapicat<sup>8</sup> që turpëronin lopën, kur mileshtin, sharat dhe bardhokot<sup>9</sup> qumesh-tore, leshgjata të buta kur zbrisnin nga mali begatonin torishtën e gëzoni pa masë qengjat vegjël kaçurrela që blegëronin duke vallëzuar lumnisht. Kërtollat sa opinga, kungulloret<sup>10</sup> e rrepat sa kosharja në gropë, gështenjat në thark, arrat në vozgar dhe mishi gomilë në trinë për mbi oxhak ishin dekorit i shtëpisë vjetër të Micajave (Mic Sokolit. Ndok Micit) në Blini të Shoshit. Prekë Ndoka së bashku me bashkëshorten Tringa punëtorë, satanice e bujare e çuan edhe me lart në ketë kullë në atë oaz të vetmuar Edenian në ato kohëra kur neper lagjet e mëdha të Shoshit mungonin turshitë dhe lëngu i djathit. Shtëpia e tij që paradhoma hyrëse e skajit JP të Shoshit. Në dukje te pare krejt e vetmuar, por faktikisht e shumë frekuentuar, nga Toplana, Dushmani, Berisha, Molla,- e Pepsumaj por jo pak as nga Shoshi e Shala etj. Tervrsa e tij kurrë nuk diti ç'ka është zgripi i bukës, djathit, rakisë mishit, mazës venes kosit dhe mjaltit. Prekë Ndoka nuk qe vetëm ndera e Blinit dhe Gurit të Lekës por e gjithë Shoshit Lypsari, i rreckosur i

mbetur pa shtëpi mbi krye nga fatkeqësitë natyrore gjeti bukën, ushqimin ose frymën e berrit. Në atë derë u këndellën i shtegtarit i dërmuar nga udhët



Çifti Ndoka Preke Ndoka, në festivalin folklorik kombëtar në Gjro-kastër

përgjatë, atyre horsteve qiell prekesë, u rehatuan festarët, gostaxhitë, dhe miqësia e qefit, burrat fisnik, por edhe qyl ngrënësit e qyl pisit. Brigada e Kooperativës, brigadat e punëve vullnetare apo ato kulturore kur shkuan në Blini kurrë e nuk morën, bukën me vete se atje kishin të shtruar tërvesën gomile. Një ditë rëndomte shpërndarje plehu apo zhveshje kallamoqi nga brigada e Mollës në Blini në darke kthehej në dasmë me mish venë raki këngë e shpoti qa sa edhe bora në Cukal shkrihej prej gazit. E kama pare me sytë e mije se sa bujarë i pa përmbajtur ishte Preka në shtëpi të vet, ndërsa në shtëpinë e huaj gjithë ai div miçlonte sa një fëmijë, duke treguar veten si bujare rrace. Prekë Ndokë Qeten e njoha si një nga njerëzit më punë mirë të Shoshit në gjitha punët e bujkut e blegtorit pse jo dhe te mjeshtrit, ndër kohë që kurrë

nuk e pashë të pa larë, të pa krehur as te pa rruar. I veshur hijshëm pastër i tejet i ujdur me këmishë te bardhë si bora xhakete e pantallona stofi apo teritali bluh nuk mungonte ne dasma, morte festa dhe aktivitete shqërore dhe artistike qe në atë kohë kishin një masivitet te pa besueshëm për brezat e sotëm. Te beje tre ore me këmishë fringo nga Blini në Pepsumaj dhe vije asaj rrugë qe meandronte shtatave të pyllëzuar me lisa e shkurre vetëm Preka e bënte. Po si bënte dhe kur hynte ne mes shoqërisë ishte sikur kishte dalë direkt nga rafti? Ja si bënte pasi e kam pare vete. Hiqte këmishën, mbante veshur kanatierën kur koha ishte e freskët sipër kanatiers vishte xhaketen dhe kemishën e mbante në dorë, rreth qafës vinte një faculetë të bukur me cilën fshinte djerset. Në hyrje te fshatit tone te Gurra e Sipër ndalej lahej flladitej si qe dimër si qe verë hiqte kanatierën dhe vishte këmishën dhe shkante atje ku ishte nisur krejt i pa djersitur. Preka ishte njeri social i qeshur i thjeshte i respektueshëm dhe rrema të këndshëm humori pozitiv. Korrekt dhe i përpiktë vinte në aksion vullnetare aktivitete shoqërore para të gjithëve ndonëse shtëpinë e kishte më i larg se të tjerët. Punonte krah për krah me ritë e sa po dalë në pune të moshuarit dhe gratë i ndihmonte dhe ua bënte gjysmën e punës prandaj Prekën e donin dhe respektonin të gjithë. Ka qene veprimtarë shoqërorë i thjeshte fjalë pak anëtare Këshilli dhe komisioner për vlerësimin e mallrave në natyre të anëtarëve të Kooperativës. Preka pa kurrfarë interesi gjithmonë anonte nga interesi i fshatareve, më varfërve me shumë e sidomos i pleqve vetmuar si Mirash Zefi e Mrikë Dautja, Zojë e Mehil Kola, Lulë e Ndue Biba, etj ku çmonte në natyre sasinë e rrushit, kumbullave e gështenjave. Zemërgjerësia e tij ra në sy të intrigantëve ndaj ja gjeten marifetin dhe zëvendësuan pasi kishte të tjerë qe nuk toleronin as për babën për hire të interesit të Kooperativës Ishin pikërisht ata që pas viteve nëntëdhjetë morën teserat reja dhe u bënë agitatorëve të zjarrtë antikomunist. Ka qenë për disa vite anëtare e trupës gjykatës popullore të fshatit ku vazhdimisht tregoi maturi dhe integritet. Preka nuk kishte kohë të merrej me transport as fabrikim fjlësh ishte i drejt per drejte. Llafazanet dhe dembelët kurrë nuk u beri iso as shoqëri. E keni kollaj ti Bal Marku, Ndue Biba e Pjetër Koca i patë thënë dy tre delexhi përgojonini të tjerët e s'punon as gjë. Po heqi vetën prej asaj liste se jam më i ri, por fort ma kollaj e keni ju që jeni në lulë të moshës e ata janë në moshë te pensionit Tamli, tylyni djathi e kosi nuk vijnë pa luaj vendit me mbajt bagëti me u vu tagji e me shërbye te bishti ditë për ditë. Statuti thatë mbaji 20 bagëti e një lope pse nuk i mbani sa rrini kaq njeri e tjetri e ku po shkojmë me hangër një darkë apo drekë qyl. Në mesin e viteve shtatëdhjetë ndonëse ishte padyshim nga shtëpitë me të kamura te Shoshit u largua dhe shkoi me pasaportizim ne Ajasëm ku natyrisht i vëllai shembullorë Nikollë Noka i hapi rrugën

<sup>7</sup> Laruka, kuqesha emra lopësh

<sup>8</sup> Dhi pa brirë dhe me brirë si sqap

<sup>9</sup> Emra delesh

<sup>10</sup> Lakra kokërr mëdha

Prekës dhe dy vëllezërve të tjerë. Preka ishte i fundit dhe u largua i përletur i për-cjellë me dhembshuri nga gjithë Molla e Pepsujt. Prekë po na vetmon që po largohesh e po dhimbesh;-i tha Bal Mark Milani. Ke qenë ma para prite dhe tërvësë e madhe Shoshit kufij me tre fise. Bal Marku ju dhimbesh Zotit! Qebesa pa dal për hatër të shkollimit të fëmijëve se për hir të trupit tim kurrë nuk do lëshoja këtë vend që kam derdhë gjithë atë djersë. Po largohem por kudo që shkoj shoqëri ma të mirë se këtu nuk kam me gjet! Kudo që do shkoi vend më të dashur nuk do gjejë se këtu ku linda e u burrova;- tha Preka. Buza iu dridh dhe i shpëtuan dy kokrra loti në faqe ndërsa zëri i pësoj në kordë përdredhëse. Prekë Nkokë Qeta që nder migruesit me të hershem të Shoshit në atë shterngicë hermetike. U punësua --- dhe u mire integrua më se mirë, ndërtoi shtëpi te re dy katesh, dhe u be nder më kamurit e lagjes. Shtëpi e madhe në Shosh po ashtu në qytet, bujarë një lloji së në mal ashtu dhe fushë, shkolloi dhe edukoi në mënyrë shembullore fëmijët që iu benë të te suksesshëm në shkollë, karrierë dhe ne biznes aq sa vdiq i përmbushur për gjithçka beri e la pas. Se bashku me të vellanë Nikolën ishin njohës shumë të mirë folklorit, te riteve dokeve besimit dhe kanunit të Lekë Dukagjinit, ndonëse as njëherë nuk e rrahën gjoksin si disa si gardist "martir" ligjeve të Lekës.

#### PRITI PRITI BRE BISHAT!

Koha ishte e mrekullueshme ! Dielli sa po kishte nisë udhën drejt perëndimit. Hijet e lisave po zgjateshin ne drejtim të kundërt të diskut të artë. Bungaja e krasitur hijshëm kish ra në një dremetje të ëmbël, nga vapa e mes ditës. Palat e dushku të palosura hijshëm në hamallë ngjani si dele të mallim. Gjethet e bungut dhe të frashrit të buta si safjani kundërmonin një aromë të këndshme dhe bënin thirrje duam të akomodohemi në mullar se dielli i ditës se nesërme do na gëzhasë . Thirrjes së tyre iu përgjigjëm, ndaj kishim gjithë paraditën që po punonim bashkë me gjyshin tim Balë. Unë ende mjaft i ri dhe bjerrtë atë vit do filloja klasën e tetë, ndërsa, gjyshi mbi të gjashtë e pesë, por trup lidhur, i fortë punë mirë që punës nuk i ngutej as nuk i tutej. Fillimisht nxorëm një vidrak shtylli ahu e ngulëm dhe e fiksuam pasi një trung qarri duke e lidhë me shtat palë fije thuprash te dredhura shkoza sa as "Cunami" nuk mund ta lëkundte. Gjyshi ishte mjeshtër sistemimit të tagjisë në mullarë, gjë te cilën ma mësoj edhe mua dhe përvetësova shumë mirë më vonë . Dushqet që vinte ai ishin 35-40 apo edhe 50-të barrë<sup>11</sup> As një palë nuk i kalbej çungjet e rremave i vendoste në mënyrë simetrike sikur i kishte futë në shestë. Për t'i ngjeshë mirë gjithmonë përdoret një ose edhe dy gur peshakë. Gjethen e niste të gjerë e lartësonte rreth katër metër dhe mbyllte duke marrë formën e shishes më një hijeshi si statuje femërore. E kishim llogaritur që këtë punë ta bëni për dy dit. Dalë nga dalë mblodhëm dushkun që ishte rreth shtyllit dhe e stivasëm mirë Unë turresha të ngarkoja sa më shumë. Prelë vetëm një ose shumta dy pala do ngarkosh. Je ka rritesh pesha e

rëndë të këpute. Kurë e pyetën malin dikur se kujt ia ke frikën mali:- tha atij që ngarkon lehtë e shpesh. Ai që ngarkon randë nuk kanë ç'më të bën se mbyttë vetin. Unë nuk ja vura veshin dhe mora 5-6 pala dushku një herësh. Gjyshi paska qenë duke më pa dhe me bërtiti. - Shazotën e ule ne toke dhe po guxove me përsëritë ma të nisa tek stani. A more vesh me;- tha rrebtë?-, Po fola unë i zanë faj. Mallkue kush i ngarko fëmijët shfreu. Një palë e dy nuk të bëjnë as gja. Jo more jo ma tepër nuk e ngarkoj një nip të vetëm . Dushkun e bajë unë ndërsa ti ma qit ngadalë ngadalë në mullarë.... Pasi hollëm themelet dhe rrafshuam "coklaturën" e dushku , hëngrëm drekën me bukë te gatuar në vatër, djathë, kastravecë bjeshke, domate të kuqe qepë mishtë thatë dhe lalltë të freskët siç dinte ta ndante duararta gjyshe Katrina<sup>12</sup>. Gjyshi e kish zakon si në homallë si në livadh,shat apo vade flinte një ore. Gjumi e zinte një cope si me telekomandë , ndërsa mu as atëherë as sot nuk e zë pa iu lutur fort haje o i bekuar . Sa po u zgjuam nga gjumi dëgjuam një kuvend të lehtë. U ngrita e pashë Prekë Ndokën dhe Shan Bibën e Mollës po ngjiteshin kthesave gjarpërues afër Elterit të Rrahit<sup>13</sup>. Para tyre një mushke kuqe e ngarkuar rëndë dhe djersitur ecte hovshëm. E njoha ishte mushka Prkës. Pas sajë Preka mbante mbi sup një thes të bardhe mesatarë, ndërsa Shani kishte ngarkuar një zhabë të madhe gjashtëdhjetë okshe shtërnguar mirë me balq të endur nga bashkëshortja Mrikë që nihej si njeshtre e punës me dorë. Preka ecte



Preke Ndoka, në festivalin folklorik kombëtar udhëheq Gjamen, kushtuar Gjergj Kastriotit nga Leke Dukagjini

shërbes fillikat i drejtë, as nuk ja ndente fare për thesin më një vese djersë të lehtë. Shani pa këmishë i shkurtër i shëndetshëm, gjoksi leshatarë sterr i zi kullonte djersë sikur kishte dalë nga lumi. Gjithsesi vazhdonte qete, qetë maratonën e zakonshme që për brezat e sotëm është aventurë e jashtë zakonshme dhe e pa rritshme. Pak me tej atij vend pushimit ishim duke u përgatit për rifilimin e punës. Udhëtarët e pa përkulur ulën barrët u pyetën me gjyshin edhe mua duke kuvenduar plot dashamirësi. Ledinë e paske nise këtë dushk;-tha Preka. Shazotën ja priti Shani edhe ai punëtorë shumë i mirë këtu janë dy shty gjethe- Po, por thash ma mirë t'i bashkoj në një vend se sa nxjerr dy shy, dy

shtroja e dy mbuloja. Bala gjeite tagjitë dhe punët e burrave i ka ba gjithmonë veç shokëve- Shazatën nuk e pate vështirë me ditë ia ktheu Shani që hala kullonte djersë.- Shan mbasi na bashkoi Zoti a i ndihmojmë këtij punëmiri me afrua këta dushk rrethi shtyllit . Shazotën nuk po dhimbet vetja grimë. por jam tha për ujë.- Shko djalo më te rraja e ahut e bjere atë bidon:- më tha gjyshi. Drue se aht i nxehtë e nuk ma shuan etjen as një fije;- tha Shani.-Provoje një herë se nuk e besoj;- i ktheu gjyshi . Ne kishim marre dy bidona 5 kilogramësh secili njeri akoma ishte i pa prekur. Gjyshi e kishte mbështjellë në fier te njome dhe vu afër tokës ne një rrajë ahu Ujë që aq i ftohte sa Shani u befasua. Amanet pijë sa te dush se gjithë ajo djersë duhet zevedesue- tha Gjyshi. Shani i piu sikur dy kile pa ja nda dhe i kënaqur :-tha qebesa paska ndejte si me kenë mbushë tani te gurra. Preka piu normalisht dhe pa zgjatë duke qeshë thirri. -Çohu bre Shan he harushan! Preka veshi një setër doku të gjyshit, ndërsa Shani, lakuriq në brez e sipër ia filluan punës gjithë duhi. Ishin përveshur e trimëruar me shqye krejt malin. Prelush ti po mujte me ja palu dushkun Shanit ke punë boll. Po, po ashtu bana. Ia nisa me stiva mesatare, por Shani më qortoi. -Ç 'ka je ban?! . Shazotën po nuk mora nga 80 ose 100 kile me duket rruga bosh. Unë i çuditur fillova të zbatoi porosinë. por nuk isha në gjendje te palosi një turrë pa ardhe Shani me marrë tjetrën. Në njërën anë Preka dhe në tjetrën, Shani e përulanë dushkun dhe boshatisën homallën. Per punë një ore sollën rreth shtyllit

Shko e ma sill bidonin edhe një here.- Hidhja pak ujë se ju ka nxe motori "Tatrës",- thumboj Preka. Si i zanë faj shkova rrëzë ahut dhe i solla jo ujë por kungullin e llallës, pasi na kishte mbet sikur edhe një treta. Llalla e freskoi dhe qetësoi Shanin.- A po i lë gjë Prekës e pyeta unë? Shazotën as një pikë nuk po kërkon Preka as ti pasi më qeshet për karambolin. Edhe ujë e keni tepër;- tha Shani duke nga kthyer revanin gaztor.... Edhe kur isha student vite më vonë në shtëpinë e tij në Ajasëm Preka më pyeti a ke pa ma bisha të tilla në homallë?! -Besa jo qeshja unë.- Shëndosh kjosh se as nuk ke me pa.-Unë u plaka e Shani na ! Më vjen keq se "dragua" si ai nuk rritë ma toka e Shoshit!... Shpesh sforcohemi t' veshim heroit me petka epike që u bien ose gjanë ose shkurt. Motive të tilla jete janë shumë mbresëlënëse Ai brez ishin heroi të punës, sakrificave solidaritetit dhe shpotive të njerëzishme. Akoma më në thellësi të viteve femiore më kujtohet një episod sikur të kishte ndodhur sot para ditë... Ishte viti 1971 po digjnim një furrë gëlqereje në vendin e quajtur Lugu i Brejt pas shtegut të Krelit. Kureshtja si mund të digjej guri e behej gëlqere më bënte pas ditëve të shkoja e shihja e rrija gjatë me Kolë Nduon e Brashtës që punonte se bashku me vëllezërit Gjoni e Marashi, punëtorë aq të mirë e ta pa hile sa nuk përshkruhen me fjalë. Kur furrës i delte flaka në kulm, tregonte se guri ishte pjekë. Mos gabofsha pas 48 pushim zjarri duhej hapur. gurët e pjekur përfundojnë në pus ndërsa uji e shuan e bën "kos". Ditën që hapem furrën gjyshi Balë kishte thirre mbi 30 veta të banin me kosha. Furra ishte pas një shtegu këmbësore rreth 30 minuta larg. Edhe Preka ishte i ftuar në atë tubim të vështirë, por erdhi rreth dy orë tre ore më vonë. Zef Ndoja i Gurit të Lekës i kishte falë gjyshit një tërvësë të jashtëzakonshme me dërrasë bredhi me perimetër sa dy sofrat të zakonshme. Baba(Bala) i kish thënë, Prekës ma sill atë tërvësën kur te qesin rruga, se po nuk ma solle ti vështirë ma sjellë kush tjetër . Atë ditë Preka vendosi që bënte një rrugë e dy punë. Shumica e njerëzve që e njehnin atë rrugën të ngushte këmbësore thike për gjatë shpateve shkëmbore, edhe sikur të ishte arit nuk do mund ta bënë atë që beri Preka atë ditë majit pak të vërejtur e njomur me rig te lehtë shiu ...Balë tërvësën ta solla. U vonova por qebesa punëtorin si ma i miri e qes,- tha Preka duke pi një kafë një gotë raki që i dukej gjatë me pa u bashkua çetës punëtorët - Te lumtë Zoti krahët se qe besa ma të mirin argat e ke qitë ja;- ktheu gjyshi. Preka u ngrit e mori një kosh dushku.- Për ç'ka more Prekë ,- pyeti gjyshi? - Kam ardhë me vonese dhe po mbushi me thika guri;- ia prit Preka duke qeshe. -Ruaje vetin se nuk nevoja kam thirr plot punëtorë dhe gëlqeren po bajmë pa u kopat as kush. Po ku pyeste Preka ishte kolos i vërtetë Më kosh të vogël më duket vetja shumë i vogël qeshi preka... Në drekë për çudinë e gjithkujt në tërvësën që kish sjellë Preka u shtruan për të herë të parë në shtëpinë 15 veta kambëkryq pa ra as një fije shtrenjtë.

Nga PRELE MILANI

<sup>12</sup> Katerinë Prekë Milani gruaja e Bal Mark Milanit

<sup>13</sup> Quhej kështu një pushim hijenik aty kishte një kryq druri një pramak me mur guri të thatë ku ulnin barrët e shpinës disa shtegtare. Para pramakut ishte një djerrine e vogël ku edhe mund të shtriheshe

<sup>11</sup> Barrë-Njësi matëse ngarkese 50 kg.

# SHQIPET E SELCËS

Tek freskohesha tek ai burimi këndshëm në Fushëlojë bri Cemit, ku çdo rrugëtar zor se kalon pa u ndalur, dëgjova të këndonte dikush në ahishtën, aty afër, një kënge, fjalët e secilës dua t'u përcjell këtu edhe lexuesit:

Njaj Gjekë Selca me Preng Bibën

/ prej Mirdite

Dhe Gjergj Lulen si yll drite...

Thrrasin djemt ta shpejtojnë kamben

N'urë Tamares vrap me u gjete

Se i brigadë he u bajsha gjamen

N' atë Lug Cemit kanë zatetë

Behej fjale për atë ngjarje të lavdishme, për të cilën kisha marr rrugën për në Kelmend.

- Nuk shkojnë kot bijtë e kësaj toke! - Thashë me vete.

Ndërsa unë meditoja plot respekt për luftëtarët e lirisë, ai zë i panjohur, por gjithsesi i bukur, sikur më thoshte, se gjaku i tyre nuk mund të përlyhet, as nuk e tret koha, as nuk e thajnë vitet. Ai kurrë nuk do të humbasë në këtë tokë martire.

Kush ishin Gjekë Selca dhe Gjergj Lula?

Kelmendi sigurisht i njeh më mirë se unë, e nëse nuk do të them ndonjë gjë të re, le t'i pranojmë malësorët e Kelmendit, përpjekjet e mira, si homazhe për këta fajtë të Selcës.

Linden në Selcë në vitin 1913. U rriten bashke si shoqe të pandare. Të tillë mbeten gjithë jetën, të cilën e mbyllen burrërisht, në vitin 1945.

Ata, si gjithë malësorët e tjerë, ishin ushtarë të fatit, të bindur ndaj normave të moralit dhe kodit të pashkruar të Maleve, ku lufta për lirinë, fenë dhe traditën është më se e shenjte.

Nga pamja ishin diametralisht të kundërt. Gjekë, një malësorë tipik, relativisht trupvogël, por i panënshtueshëm. Energjik, tepër i lëvizshëm, me një karakter sanguine të theksuar. Sy shprehës, me një vështrim hetues, i pajisur nga natyra me një intuite dhe gjykim të sakte për atë, që mund të humbet, pa llogaritur fare jetën e vet. Me ndërjegje, i ndershëm e ndoshta nga kjo manifestonte në vetvete një fare admirimi të tepruar për armen si mjet, për të zgjidhur shpejt problemet me ato që cenojnë normat e kanunit dhe të traditës.

Tek Gjekë, në raste të veçanta, shfaqej furishëm ai temperament karakteristik idhnak dhe i papërmbajtur, që në raste të veçanta e kthente në hakmarrës të zakonshëm.

Gjergj Lula, kelmendas tipik si i derdhur në bronc nga një dore mjeshtri. Mbi ata shpatulla azgani, perëndia kish vendosur me kujdes një kokë të bukur, rinore, me tipare të përkryera. Sa energjik dhe i vrullshëm, aq i qete dhe i sinqerte. Një

ekuilibër relative që evidenconte tek ai një tension të brendshëm dhe të përhershëm, i cili e bënte më karakteristik atë profil të bukur burrëror.

Shkurt, një qenie inteligjentë e pajisur përveç hijeshisë edhe me një mprehtësi natyrore mbi të cilën bjeshkët e Kelmendit kishin derdhur aq bujarisht çfarë kishin më të bukur. Edhe ky, si bashkëmoshatar i tij Gjekë, nuk përshtatej lehtë me pritjen, me durimin e gjatë, i dukej si nëpërkëmbje, nënshtrim, nuk përshtatej as edhe me përpjekjet e fshehta dhe dinake. Sapo qartësohej situata plotësisht, bëhej tjetër njeri ... Sigurisht, që ai anohej në anën e së mirës së vendlindjes.

Në vitin 1941, te dy mobilizohen në ushtrinë shqiptare. Fati i hodhi në jug të vendit, në ato territore shqiptare, që shërbenin si prapavija të ushtrisë italiane, që ishin në atë konflikt, që njihej në histori si Lufta Italo - Greke, shkak i së cilës, ende ekziston paradoksalisht ligji i luftës në mes Greqisë dhe Shqipërisë.

Politika e qeverisë së Mbretit Zog në mërgim i përmbahej një strategjie në shërbim të përpjekjeve për të shpurrur pushtuesit fashiste nga Shqipëria, që konsistonte në veprimin evaziv ... "Asnjë veprim luftarak kundër forcave greke, por as edhe një veprim për të ndihmuar ata" ...

Aktualisht nuk kemi asnjë të dhënë konkrete mbi të cilën të gjykojmë se sa iu përmbajtën kësaj politike, por, dimë që Gjekë Selca dhe Gjergj Lula qene shembulli më i mirë i trimërisë, i besës dhe i burrërisë. Kelmendas të vërtetë. Gjithmonë pranë tyre Preng Biba prej Mirdite. Jeta në ushtri kish kalitur në mes tyre nyje të përjetshme besnikërie, që do të provohet edhe në ngjarjet tragjike të dimrit 1945.

Fal korrektësisë, gatishmërisë, guxim-it, trimërisë, që e karakterizonin, Gjekë Selca ndjehej mirë nen uniformen ushtarake. Në detyrën e rreth -komandantit në Nënprefekturën e Malësisë së Madhe, me qendër në Tuz, në krye të së cilës qëndroi deri në vitin 1944, ai punoi me përkushtim për të harmonizuar marrëdhëniet e popullsisë shqiptare, duke shmangur ngjarjet politike apo kufitare, gjë që nuk kishte kaluar pa u vene re nga fqinjët dashakeqes.

Çlirimi i vendit, Gjekën dhe Gjergjin i gjene në Selcë, në mes të malësorëve. Antikomuniste të palëkundur, të vendosur për të ruajtur të pastër Kelmendin nga idetë e kuqe të të pafeve.

Pjesëmarrës në kuvendin e Brojes. Më pas eksponent aktiv në organizimin e rezistencës me arme për të penguar nënshtrimin e Kelmendit nga forcat partizane.

"Ndërsa seljanet e pleqëruan për t'u mbrojtur në kufjet e vet, Gjekë Selca, Gjergj Lula dhe disa të tjerë shpejtuan për t'u gjendur sa më pare në log të luftimit bashke me vëllezërit e tjerë kelmendas" ..., shkruan Halil Buçpapaj, në librin e tij. Kështu ata u bënë nga luftëtarët më të guximshëm nga të gjithë antikomunistet shqiptare.

Ndërsa, në Kelmend mbretëronte dhu-

na dhe terrori, Mehmet Shehu, me shumë djallëzi shpall një amnisti për të gjithë ish ushtaraket, që kishin marr pjesë në rezistencën antikomuniste, në Malësinë e Madhe. Në grackën e kësaj amnistie dhe të përbetimeve të Abaz Fejzës, për t'a trajtuar dorëzimin si një kalim të vullnetshëm për anën e partizaneve konforme statusit ushtarak, duke i përjashtuar nga pasojat si pjesëmarrës në rezistencën antikomuniste, ranë si shumë malësorë të tjerë edhe Gjekë Selca dhe Gjergj Lula.

Menduan fatzezët se edhe komunistet, si çdo njeri që flet shqip, fjalën e dhëne e quajnë besë dhe, se edhe për ata, ajo vlen më shumë se çdo gjë tjetër dhe pranuan të takoheshin me partizanet.

Ky takim, sa naiv aq dhe fatal, është bërë në shtëpinë e Mark Martinin, në Selcë. Shumë pak gjera dihen rreth atij takimi, por dihet me siguri se aty ka pasur edhe konfrontime deri në përleshje me grushte, vetëm pas disa orësh të tensionuara Abaz Fejzo arrini të bëhet i besueshëm dhe trimat dorëzohen. Ndërsa shtabi i Korparmatës së Tretë në Shkodër e konfirmon ndryshe ... Prej forcave të Brigadës së Partizane, në Malësi të Madhe, u arrestuan oficeri i xhandarmërisë Gjekë Selca, rreshteri Gjergj Lula dhe Nëntogeri Preng Biba ... 360

Amnistia, që proklamohej si besë, ishte një truk, që përbente shembullin tipik të dinakërisë së paskrupullit komuniste.

"Në burg gjeta Gjekë Selcën dhe Gjergj Lulen, me të cilin kisha edhe njoftësi. Ato ditë, kur të burgosurit dilyn në pushim, shëtitje në oborrin prapa burgut, shëtisja dhe bisedoja me të" - shkruan Marash Mali 361, - më kujtohet, kur një herë më pyeti si zakonisht, duke qeshur: - A thua do të vijë ndonjëherë dita, që të dalim te Kroni i Dedajva, në qafë të Predeleci? ... Pa tjetër, që po, - I thoshe ... Përfundon autori.

Ky kolos i rritur në gjirin e bjeshkëve të Kelmendit dhe i edukuar me ligjet e pashkruara të tyre, ishte i ndjeshëm dhe delikat ndaj natyrës. E vlerësonte atë si një dhuratë të Zotit, që do ti mungonte ...

Në muajin prill të vitit 1945, populli i traumatizuar i Koplikut do të përjetonte një ngjarje sa tronditëse aq edhe të pashlyeshme në kujtesën e gjithsecilit. Ja si e përshkruan këtë ngjarje të dhimbshme Caf Nuz Culaj 362, në atë kohë aktivist i Frontit Nacional Çlirimtare:

"... Pushtetarët e Koplikut njoftuan popullin e Malësisë, që të merrte pjesë në një miting të madh, që do të zhvillohej në qendër të Koplikut, ku do të vinte një delegacion i huaj. Kopliku ishte mbushur plotpërplot, por delegacioni i huaj nuk po dukej. E gjithë kjo ishte një loje e pushtetit në fuqi.

Për çudinë e të gjithëve nga Dega e Punëve të Brendshme, në drejtimin e turmës sjellin dy vete me pranga në duar e të lidhur me litar në bel me njeri-tjetrin. Populli i njohu menjëherë, ishin Gjekë Selca e Gjergj Lula. Të burgosurit çanin turmën, duke ecur ngadalë. Ecnin të qetë e me kokë lartë. Të dukej se po shkonin në dasme a në një ceremoni, e jo drejt vdekjes. Përsëritet ndonjë të njohur me buzëqeshje ose me një lëvizje të kokës. Të burgosurit shoqëroheshin nga një skuadër ushtaresh me automatike në duar.

Në të dalë të Koplikut, mbi karrocërinë e një kamioni të prishur, ishte sajuar "turma". Në te qëndronin tre oficerë, që përbenin trupin gjykues dhe Çun Jonuzi, që ishte komisar i rrethit. Prokurori lexoi akuzën, që ishte ndërtuar me shpifje e trillime. Edhe Çun Jonuzi, pasi i përsëriti ata, i beri thirrje popullit, që t'i mbështesë ata e të dënonte kriminelet.

Askush nuk hapi gojë. Një hije e zeze kishte pushtuar sheshin ..., - përfundon autori.

Ketë heshtje, që u duk se zgjati një shekull, e prishi trupi gjykues ... u lexohet vendimi, që në emër të popullit i dënon me vdekje ... formalitet partizan ... Sa i gjate ky formalitet i kobshëm, e megjithatë, është gjithçka që mbetet nga jeta e tyre. Ishin vetëm 32 vjeç. Në më të mirën e kohës. Çdo të kenë menduar trimat gjate leximit monoton të atij vendimi në një dialekt, që pak e kuptonin ...? Ç' përjetuan ato në këto minuta të fundit? Asnjëherë s' ka për t'u marr vesh. S' ka pse të hamendësojmë kur e kemi të qartë dhe autentike fjalën e fundit të Gjekë Selcës:

.... "Une jam ushtar i atdheut dhe antikomunist deri në vdekje. Nuk kërkoj mëshire, mbasi mëshire kërkojnë fajtorët e frikacakët, e unë nuk e njoh veten si të tillë. Shqipërisë i shërbeva ndershmërisht dhe Malësinë e desha me gjithë zemër. Para saj vdes i qete.

Ju sot na quani radhe tarë, por historia do të na njohë si dëshmore dhe atdhetarë ..."

Ndërsa Gjekë fliste ..., Gjergji ishte çuditërisht i qete, sodiste të afërmit krejtësisht gjakftohtë. Në dëshirën fundit kërkon të mos e çartin në fytyrë. Sa interesant është malësori, pas trimërisë, besnikërisë dhe nderit, e dyta për te është: pashija e fundmja dëshirë, që dilte ndoshta nga thellësia e shpirtit si shprehje e dashurisë për jetën, për njerëzit sidomos për nënën e tij, që s'donte t'ia mjegullonte kujtesën.

I pushkatuan publikisht dhe i varrosen tinëzisht përfund një livadhi në Kopluk. Për gati gjysme shekulli, vetëm hija e heshtur e ndonjë shqiptarë kalimtare si një përkëdhelje, që ka frikë se mos i trazon, rrëshirti mbi varret e tyre. Këtu ato gjeten paqen, por jo harresën.

Ka vite, që ata prehen e nderuar në varrezat e vendlindjes së tyre, Selcës. Aty tashme janë rritur lisat, hija e të cilëve duket sikur përpigjet të fshehe në kujtesë atë fund të vështirë, atë lëngëzim të përvojshëm, të pa shembullit në historinë e popullit fisnik të Malësisë së Madhe.

DR. LUIGJ MARTINI




Gjekë Selca



Gjergj Lula

# KANUNI – DËSHIMI E QENËSISHME E LIGJËSIVE TË LASHTA TË JETESËS SË NJERIUT TONË



## TRASHËGIMIA GOJORE: KOHËT E GJALLIMIT DHE KOHA E SHËNIMIT

Kurdo dhe në çfarëdo mënyre të flitet për trashëgiminë kulturore shpirtërore të një populli ose të popujve të ndryshëm, bartur gojarisht nëpër kohë, duhet të kihet parasysh, pos të tjerash, tri dukuri të rëndësishme: koha ose kohët e gjallimit (ekzistimit) të dukurive, koha e njohjes – e shënimit të tyre në formën e shkruar dhe fakti se ato nuk studiohen që të bëhen sot pjesë të jetës së përditshme, pa marrë parasysh rëndësinë e tyre, por që të njihen si pjesë e trashëgimisë që përligjin qenësinë dhe pasurinë kulturore dhe shpirtërore të popullit që i ka përdorur, aftësinë e individëve që i kanë përfutur ose i kanë bartur prej një brezi tek tjetri, duke i përshtatur sipas rrethanave dhe kushteve të jetesës. Së këndejmi, edhe veprat letrare poetike të së kaluarës së largët, fjala, “Epin e Gilgameshit”, “Iliadën”, “Vedat” etj., nuk i lexojmë për arsye se ato dëshmojnë botëkuptimin tonë e të kohës sonë, po për artin e tyre që kushtëzuan pasurimin shpirtëror dhe artistik. Në këtë rrjedhë duhet parë edhe Kanunin e Lekë Dukagjinit, për të cilin bëhet fjalë në këtë parathënie, po dhe motërzimet (variantet), që janë bërë të njohura ose mund të zbulohen e të botohen. Njeriu merret me studimin – njohjen e trashëgimisë kulturore, letrare dhe shpirtërore për arsye se, si thoshte Gadamer, “Tradita nuk është vetëm një shumë mendimesh e gjykimesh të njëpasnjëshme, po një e treta organike e potenciale, e cila aktualizohet e riaktualizohet në mënyrë të domosdoshme në çdo gjykim të ri” ose, siç theksonte Tommaso, “Një popull që nuk e njeh kohën e kaluar është fëmijë ose i pamend. Një po-

pull që e përbuz është i bjerrë”.

Është fakt i pamohueshëm se dukuritë e tilla, të pranishme në Kanunin e maleve, Kanunin e Lekë Dukagjinit si dhe në kanunet e tjera të traditës shqiptare, janë të ndërlikuara dhe kanë në vete shtesa të ndryshme të kohëve dhe të rrethanave nëpër të cilat kaluan dhe ndryshuan.

Meqenëse, disa shtresa të këtyre dukurive zbresin në thellësi të kohëve të largëta, për to nuk do të mund të thuhet asnjëherë mendim i prerë, siç ngjet edhe me mitet, që dikur bënë jetë gjallërike, po me kohë u zbehën dhe u zhdukën, siç ndodhi edhe me këngët tona kreshnike, të cilat në shtresat e lashta të tyre shqiptojnë dukuri të një bote të lashtë, që kryesisht lidhet me matriarkatin. Me një fjalë, e vërteta e mirëfilltë për përcaktimin e kohës së lindjes së varianteve të para të kanuneve, duhet parë si përcaktim të arketipit (formës së parë) të krijimeve të letërsisë gojore, që na vijnë nga lashtësia, që mbetet e pa mbërrishme.

## SHKASI I PARË OSE NDËRLIQËSIA E NJOHJES SË VARIANTEVE

Nga çasti kur njeriu u bë i vetëdijshëm për veten dhe për veprimin e vet dhe meqenëse jetoi në bashkësi vëllazërore ose fisnore, krahas këngës dhe rrëfimit, ai synoi t’i përcaktojë edhe rregullat e sjelljes, në të cilat do të mbështetej jeta e të lehtësohej mënyra e veprimit të përditshëm.

S’do mend se këto rregulla në fillim ishin të thjeshta e të kufizuara, po me kohë, ato u zhvilluan dhe u pasuruan dhe në formata të zvogëluara ose të gjurmëve, disa mbërritën dhe në kohën tonë. Variantet e para të Kanunit të maleve tek arbërorët – shqiptarët duhet të jenë padyshim të lashtë sa

edhe vetë populli që i përftoi dhe i përdori, edhe pse ato u shënuan shumë vonë në krahasim me lindjen e tyre. Të dhënat e para të shkruara rreth traditës zakonore u botuan në revistën “Albania” të Faik Konicës, nga Lazër Mjeda e Nikollë Ashta. Kur vështrohet Kanuni i Lekë Dukagjinit duhet kujtuar se asgjë s’ka lindur rastësisht dhe se dukuritë janë të lidhura mes tyre më shumë sesa mendojmë ne. Njeri ndër filozofët e parë të Greqisë së lashtë, Talesi i Miletit (rreh vitit 626 deri 546 para Krishtit) thoshte: “[...] në qoftë se një gjë ka dalë gjithmonë nga një tjetër, pa tjetër se ka një shkak të parë në zanafillën e lindjes së çdo gjëje”.

Pikërisht duke e pasur parasysh këtë të dhënë, rrjedha e dukurive dhe njohja e tyre, pra edhe rrjedha dhe njohja e varianteve të Kanunit të maleve dhe e varianteve të mëvonshme si Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Skanderbegut, Kanuni i Bendës etj., ose disa dhe më të veçantë – Kanuni (sulli) i tëbaneve (i kullotave në bjeshkë), është e ndërliqshme, për të mos thënë se është e gjykuar të mos zgjidhet asnjëherë përfundimisht.

Ndodh kështu nga fakti se Kanuni i Lekë Dukagjinit, siç thekson Fishta në parathënie e botimit të parë (Shkodër më 1933): “Metaforikisht shënjon shtillin e ligjevet gojdhansë e të pakodifikueme, mbas të cillave ecte dikur hullija e jetës e veprimit të popullit shqiptar”.

Në Librin e të vdekurve dëshmohen rregulla të ngjashme: Toti, prijësi i qiellit, i tokës dhe i nëntokës, krijuesi i jetës dhe i të gjitha kombeve, thotë: “I dhashë frymë (ajër) atij që qe në vendin e fshehtë me anë të fuqisë së fjalëve magjike të ligjërimit tim, dhe Ozirisin ngadhënjëu mbi armiqtë”. Po kështu, te Epi i Gilgameshit dëshmohej riti i vajtimit: Gilgameshi e vajton gjashtë ditë e gjashtë net Enkidunë, traditë që zbatohet në jetën e përditshme, siç ngjet dhe me besimin që mund ta parashenjojë ëndrra (që dhe ngjet më vonë). Në këtë rrjedhë, gjëmat (gjëmtë) në traditën e malësorëve shqiptarë, që bëhen pranë arkivolit të të vdekurit, kanë mbërritur në disa forma edhe në ditët tona.

## KANUNI I MALEVE DHE VARIANTET E TJERA

Shumica e studiuesve pajtohen me faktin se Kanuni i Lekë Dukagjinit (në vijim shkurt KLD) i mbledhur dhe i shtjelluar nga Shtjefën Gjeçovi, është përmbledhja më e plotë dhe më e rëndësishme e së drejtës zakonore shqiptare. Në qenësinë e vet KLD është një motërzim (variant) i Kanunit të maleve. Bernardin Palaj, një nga njohësit më të mirë të së drejtës zakonore shqiptare, thotë se Kanuni i Lekë Dukagjinit është shtesë e vonshme e Kanunit të maleve.

Edhe vetë pjesët e pashtjelluara të materialeve të mbledhura nga atë Shtjefën Gjeçovi, po që nuk u përfshinë në botimin e vitit 1933 në Shkodër, dëshmojnë për motërzime (variante) të ndryshme, të cilat janë marrë nga subjekte të ndryshme

dhe në vise të ndryshme. Studiuesi Koço Nova, që u mor më përafërt me materialet që Gjeçovi i la në dorëshkrim, shkruan: “Në pjesën e parë të dorëshkrimeve të Gjeçovit që ruhej nga sh. Emid Tedeskini, ndodheshin ndryshimet dhe plotësimet e paragrafëve konkretë që autori u bënte normave të Kanunit të Lekë Dukagjinit të shkruara prej tij dhe botuar fillimisht pjesë-pjesë gjatë viteve 1913 e vijues në të përkohshmen françeskane. Gjithashtu në këtë pjesë të përpunuar të dorëshkrimeve të tij autori kishte vendosur disa shtesa lidhur me institute të patrajuara në botimet e sipërme siç janë: “nusja në pjakje”, “grueja me shtat të xanë”, “martesa me fjalë”, “martesa me barrë të vrame”, “grueja e dhunueme” etj.

Në pjesën e dytë të këtyre dorëshkrimeve, që përbëjnë gati dy të tretat e tyre, janë vendosur një numër jo i paktë normash kanunore (178 të tilla) si dhe disa vërejtje („,oroë”) e konsiderata të tjera të vetë autorit ose të ndonjë tjetri, por të kopjuara prej tij, që bëjnë fjalë për institutet më të ndryshme të Kanunit, të cilat autori nuk arriti t’i sistemojë në vendin përkatës e t’i krahasojë me të parat”.

Duke ndriçuar edhe më tej natyrën e materialeve të dorëshkrimeve të Gjeçovit, të lëna në dorëshkrim, Koço Nova shton: “Nga përmbajtja e këtyre normave të reja të pabotuara të Gjeçovit, të bie në sy, në radhë të parë, një prirje e theksuar për të ndriçuar më qartë e për të shprehur më drejtpërdrejt e në mënyrë më sintetike e të përgjithësuar disa institute kanunore, që vetëm tërthorazi e jo të plota dalin nga Kanuni i botuar. Mënyra koncize e formulimi i qartë e pa dykuptime i këtyre normave të dorëshkrimeve vë pikat mbi „i” mbi disa probleme të diskutueshme [...] Gjithashtu, në këto dorëshkrime, vërehet edhe kujdesi i autorit të vërë në dukje edhe karakteristikat lokale të disa normave si dhe datën e vendin e shënimeve të marra”.

Në të vërtetë, sipas të dhënave të një varg studiuesish të traditës zakonore ndër arbërorët – shqiptarët, qoftë ata shqiptarë, qoftë të huaj, theksojnë se variantet e ndryshme të kanuneve e përligjin dukurinë se trojet – viset e ndryshme i kishin rregullat me të cilat ata i përcaktonin mënyrat e sjelljes e të veprimit në jetën e përditshme brenda familjes, vëllazërisë, fisit ose më gjerë, shoqërisë ku jetonin. Herë – herë këto rregulla kishin një përdorim të kufizuar, gjenin një përdorim në troje apo në krahina të veçanta, siç ndodhi, fjala vjen, me Kullën e Junikut.

Pa marrë parasysh se variantet largohen e ndryshojnë midis tyre, të gjitha përligjin pasurinë shpirtërore dhe synimin që gjërat të përcaktohen sa më mirëfilli dhe të jenë njësoj për të gjithë, pa marrë parasysh pozitën, fisin, moshën. Aleks Laurasi vë në dukje se në kanunet shqiptare është mishëruar mençuria, filozofia dhe përvoja jetësore mijëvjeçare.

## LASHTËSIA E KANUNIT TË MALEVE


Të gjithë ata studiues që janë marrë seriozisht me Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe me kanunet e tjera, si Kanuni i Skanderbegut, Kanuni i Bendës etj, e kanë theksuar lashtësinë e të drejtës zakonore shqiptare. Megjithatë, vetë tekstet e botuara, ose ato që përmes dorëshkrimeve janë gjetur dhe janë bërë të njohura deri më sot, e përlegjin një të dhënë: disa nga pjesë të tyre, fjala vjen, që lidhen me ndorën, me martesën e me rite të ndryshme të fejesës e të martesës (nëse vajza që duhet të martohet vdes ditën kur krushqit shkojnë ta marrin etj.), pastaj mënyra e betimit (beja) edhe me gurë, mikpritja, mbrojtja e mysafirrit deri në flijimin e gjithë familjes, kulti i nderimit për të vjetrit dhe të panjohurit, gjakmarrja etj., u përkasin kohëve të lashta, përkatësisht shoqërive pa organizim shtetëror dhe lidhen me rite që në çfarëdo aspekti të vështrohen, të shpijnë në stadi të lashta të jetës së njeriut tonë. Edhe vetë gjuha, shprehjet frazeologjike, fjalët e lashta, të cilat i gjejmë mjaft shpesh dhe në KLD, disa prej të cilave u përkasin shekujve të parë pas Krishtit, dëshmon për këtë gjë.

Një nga mendimet më të qenësishme për lashtësinë, por dhe për rëndësinë e Kanunit të Maleve, po dhe të Kanunit të Lekë Dukagjinit, të mbledhur e të redaktuar nga Gjeçovi, e ka shprehur Atë Bernardin Palaj: e drejta zakonore shqiptare dëshmohej me shumë përbërës ndër ligjet më të lashta të popujve të Evropës. Për të pohuar këtë gjë Palaj mbështetej në faktin: "[...] s'këme gjetë moterzime aq të gjalla e shprehë ma klasikisht, sa nder ato shprehjet e shkurtuna mijvjeçare të kanunit të maleve tona. Sikurse në gjuhë e ndër prallat e katallajve njashtu edhe në doke e në kanune shqyptari i maleve ruejti tharmin e vet indoeuropjan. Thanjet e kthiellta të kanunit, të gjith sa lakolike aq kuptimplote, Imue neper rrymen e shekujvet ma fort se ato vallet e ktij popullit mijvjeçar, i mblon një msheftësi arkaike [...]"

Edhe studiuesja dhe njohësja e shquar e botës shqiptare, E. Durham, e theksonte lashtësinë e të drejtës zakonore të shqiptarëve, po dhe të KLD: "Ligjet e pashkruara të maleve, janë trashëguar që nga kohët më të lashta dhe janë përmblendhja më e vjetër e ligjeve në Evropë". Mbledhësi dhe botuesi i shquar i llojeve të letërsisë sonë gojore dhe i trashëgimisë shpirtërore, Anton Çeta, shkruan për lashtësinë dhe vlerën e madhe të KLD:

"Mund të admirojmë nëpërmjet këtyre normave disa ideale estetike të stërgjyshërve tanë, pasqyrë e etikës së tyre të lartë, të konservuara deri në ditët e vona në virtytet e besës, bujarisë, burrërisë, mikpritjes etj. Nga ana tjetër shohim dhe ashpërsinë e disa ligjeve në familjen patriarkale, në rendin shoqëror fisnor. Shkurt mund të formojmë një ide të përgjithshme dhe të plotë mbi marrëdhëniet që u formuan në mbështetje të zhvillimit të tyre ekonomik, kulturor si dhe në mbështetje të parimeve të tyre etike".

Natyrisht, edhe popujt e tjerë, siç ndodhi me arbrit – shqiptarët, në kodet e tyre i brumosën cilësitë e karakterit të



tyre, për arsye se një fis, një shoqëri ose një shtet quhet i lirë dhe i qëndrueshëm kur ka ligjet e përfuara në bazë të veçantive psikologjike dhe të nevojave të veta të mirëfillta.

Se kjo dukuri ishte pjesë e jetës së grupeve dhe fiseve, dëshmohej nga kjo e dhënë e popullit hebre: Kur hebrenjtë e zunë Krishtin dhe ia çuan Pilatit, që ta gjykonte, siç thuhet në ungjill, ai u tha: "Merreni, pra, ju vetë dhe gjykojeni sipas ligjeve tuaja".

Pra, dukuritë e të drejtës zakonore janë të lidhura ngushtë me karakterin e vetë popullit, me kushtet në të cilat jetoi, me pasurinë kulturore e shpirtërore të trashëguar e të krijuar. Siç thekson Erich From (Erich Fromm) "Karakterit, siç e ka thënë Herakliti dhe e ka dëshmuar Frojdi, është fati i njeriut. Struktura e karakterit përcakton se çfarë ideje do të zgjedhë njeriu, por e përcakton edhe fuqinë e idesë së zgjedhur".

Arbërorët – shqiptarët në rrjedhën e gjallimit të tyre nëpër kohë, ia dolën të ruajnë shumë rite, doke e zakone që

përlegjin një kulturë të lashtë dhe pasuri shpirtërore, që u përkasin marrëdhënieve parapatriarkale dhe paraidoevro - piane. Këtë gjë e përlegj dhe ky mendim i studiuesit malazez, Spiro Kulishiq (Špiro Kulišić), ndër njohësit më të shquar të traditave të popujve të lashtë të Evropës Jug - Lindore: "Në kundërshtim me mendimin e shumë shkencëtarëve për prejardhjen sllave të disa formave dhe institucioneve familjare, studimi më i përafërt tregon se shoqëria familjare shqiptare, sipas shumë tipareve qenësore, është më arkaike dhe më shumë autoktone sesa e jona (malazeze, sllavojugore – v. ime), e cila pa dyshim për shumëçka u zhvillua mbi bazën dhe nën ndikimin e organizimit të lashtë familjar ballkanik [...]. Në anën tjetër, shumë dukuri të organizimit familjar malazezo - hercegovas më përafërt i përgjigjen strukturës së shoqërisë familjare shqiptare, e cila për shumë tipare thelbore del shoqëri më origjinale dhe më arkaike, me mbetje specifike, herë - herë shumë arkaike të marrëdhënieve parapatriarkale, që përkon me traditën para in-

doevropiane".

Këtë gjë e kanë thënë edhe autorë të tjerë. Kështu, Walter Pein-sipp, theksonte se "[...] tek e drejta tradicionale e malësorit shqiptar janë ruajtur mirë arketipat e rendit shoqëror e zakonor të kulturave të lashta". Merita e këtij autori austriak është se ai e pa të pashprishur këtë arketip dhe në mesin e shekullit XX, në fillim në Shqipëri, gjatë luftës së Dytë Botërore e deri në vitin 1947 dhe pastaj në Kosovë (kur shërbeu si diplomat i vendit të tij në Beograd).

Po kështu, Mark Milani theksonte se lashtësinë e shqiptarëve si popull "[...] do ta kenë përshkrue grekët dhe romakët e vjetër, sepse zanafilla e shqiptarëve atje diku ka qenë" dhe përkundër që "[...] mbretit e huej dhe zaptuesit e botës vunë ushujza ndër ta për t'ua ndryshue edhe zakonet dhe për t'i çfrenue dhe rregullue simbas kal-lupit të tyre, ky popull "ka ruejtë të vetën (nënvizimi im) ma mirë se popujt e tjerë që kanë pasë aso edukate".

Lashtësia e Kanunit të maleve si dhe e Kanunit të Lekë Dukagjinit dëshmohej edhe përmes krahasimit me kodet zakonore, përkatësisht me të drejtën zakonore të popujve të tjerë, dukuri që meriton studim më vetë; përkundër afrive dhe përkimeve, kodet e popujve ndryshojnë për arsye se ndryshojnë përbërësit e botëkuptimit të tyre, të rrethanave e të pasurisë kulturore dhe shpirtërore. Për dukurinë e kulturës shqiptare dhe të akulturimit të saj, Gani Bobi, thekson me të drejtë "Faktet e zhveshura, pa u parë rendi i tyre në një sistem të caktuar dhe marrëdhënia e tyre e ndërsjellë brenda atij sistemi, brenda asaj tërësie, nuk thotë shumë për kulturën" (f. 95) dhe "[...] i njëjti zakon bëhet i ndryshëm në kultura të ndryshme, pra ç'vend zë ai në kuadrin e tërësisë kulturore dhe marrëdhënia e ndërsjellë me pjesët e kësaj tërësie". Kështu, duke e vështruar

mikpritjen te shqiptarët sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit në përjasje me traditën e japonezëve të vjetër, Kazuhiko Yamamoto, pos të tjerash, vë në dukje: "Duket se shqiptarët e kanë përdorur 'mikun' në traditën e mikpritjes të ngjashme me atë të japonezëve të vjetër". Rrjedhojë e një përkimi të tillë, sipas këtij studiuesi, është e dhëna se "Krahasimi i kulturës dhe traditës mes shqiptarëve dhe japonezëve antikë na çon tek koncepti i 'ushqimit', i cili është një element i domosdoshëm i kuptimit të Kanunit". Yamamoto thekson përhapjen e traditës së mikut dhe të mikpritjes edhe te shumë popuj: "Koncepti 'miku' dhe tradita e mikpritjes nuk gjenden vetëm në Shqipëri dhe te japonezët e lashtë, por ato kanë qenë përhapur gjerësisht në territorin masiv të Euro - Azisë dhe në kontinente të tjera që prej kohës që nuk mbahen mend. Koncepti i 'mikut' dhe tradita e mikpritjes duhet të çiftëzohen me 'ushqimin', mbasi s'ka mikpritje pa ushqim".

Ky studiuues japonez thekson se miku në shoqërinë homerike ka kuptim të veçantë dhe se në parimet e saj vërehen mjaft raste, që sqarojnë idenë ose mendimin mbi mikun dhe mikpritjen:

“Vatër parësore e shtjellimit të subjektit të Iliadës dhe arsyeja e luftës midis akeasve dhe trojanëve është padrejtësia dhe pabesia e një miku ndaj zotit të shtëpisë. Menelau pandeh se akeasit i sulmuan trojanët për shkak se miku i tij, Aleksandri i Trojës (kështu e quanin barinjët Paridin, djalin e Priamit), i plaçkiti pasurinë dhe i rrëmbeu të shoqen, duke dhunuar, kësh-tu, hapur miqësinë që i ofroi (Iliada, 13: 623-639). Akili thotë se ai mobilizoi tërë ushtrinë për të ndihmuar Menelaun dhe Agamemnonin që të merrnin shpërblim prej trojanëve, për fyerjen që u kishin bërë, duke shkelur mikpritjen (Iliada 1: 152-160)39”.

Sipas gjurmimeve të Yamamotos, përkimet e shoqërisë homerike me shoqërinë shqiptare, që përligjen nga Kanuni, shtrihen në disa përbërës qenësorë, ku, pos të tjerash, provohet se sistemi i vlerave etike të shoqërisë homerike është i njëjtë me atë të Kanunit. Nga gjashtë konceptet e Kanunit shqiptar: besës, nderit, mikut, gjakut, bukës dhe hakmarrjes, pesë prej tyre (besa, nderi, miku, gjaku dhe hakmarrja) dalin dhe në epikën homerike. Botën e epeve homerike, e cilëson patriarkati, ndërsa botën e këngëve tona kreshnike, matriarkati. Në bazë të këtij elementi bota që shqiptohet në ciklin e këngëve tona del më e lashtë se ajo në poemat e Homerit.

Mbi bazën pikërisht të ngjasimeve jetësore të popujve të ndryshëm, gjeografikisht tepër larg nga njëri tjetrit, studiuuesi japonez, K. Yamamoto, solli përfundimin se struktura bazë e shoqërisë homerike, që përbëhet nga bashkimet fisnore si familja, vllazëria dhe fisi, afrohet (përngjet) me strukturën e fiseve të Shqipërisë së Veriut (e mbështetur në rregullat e Kanunit) dhe me atë të bashkësisë së lashtë japoneze: “[...] ne jemi të mendimit se shoqëritë pa autoritet shtetëror kanë pasur kodin apo rregullat e tyre tipike, të natyrës etike e shoqërore. Studimi ynë krahasues midis kodit zakonor fisnor shqiptar, Kanunit dhe kulturës së lashtë japoneze, ku sqarojmë strukturën etike të një shoqërie pa autoritet shtetëror, na çon në përfundimin e mësipërm”

#### KANUNI – PËRLIGJEJE E PASURISË ETNIKE, KULTURORE DHE SHPIRTËRORE TË ARBËRORËVE - SHQIPTARËVE

Kanuni i Lekë Dukagjinit është një veper e qenësishme jo vetëm në rrafshin e së drejtës zakonore dhe ndriçimin e një varg dukurish që e bënin jetën e njeriut në të kaluarën e largët, por edhe për në rrafshin filozofik, sociologjik, letrar dhe gjuhësor. Ai ndërthen në vete një varg vlerash e çështjesh që meritojnë të studiohen nga rrafshet e pikëvështrime të ndryshme, nga studiuues të mirëfilltë të shumë fushave, edhe të specialistëve të një fushe. Pra, teksti i KLD ofron një lëndë sa të gjerë, aq dhe të pasur e me vlerë si për juristin, për etnologun, për etnografën, për sociologun, për gjuhëtarin, për studiuuesin e letërsisë etj. Disa nga vlerat më të qenësishme që e përshkruajnë fund e krye KLD janë ajo

etnike, kulturore dhe shpirtërore, që përligjen në forma e në rrafshet e ndryshme, si mikpritja, besa, nderi, betimi (beja), burrëria, pleqnia etj., përbërës të rëndësishëm të jetës kulturore dhe shpirtërore, që e përcollën arbrin – shqiptarin nëpër shekuj. Ky thesar i lashtë dhe i paçmuar, trashëguar e pasuruar brez pas brezi dhe mbi bazën e të cilit njeriu ynë e bëri dhe e organizoi jetesën nëpër shekuj, e lidh kulturën dhe popullin tonë me disa përbërës me kulturat dhe me popujt e tjerë indoevropianë.

Autori i parathënies së botimit të parë të KLD (Shkodër 1933), Atë Gjergj Fishta, shkruante se Kanuni “[...] asht të shprehur e shpirtit të kombit shqyptar” dhe se “[...] ligjet dokesore janë shprehje e psikohikes së popullit”. Pikërisht pse ishte i tillë KLD u zbatua shekuj me radhë, madje edhe kur populli ishte nën sundimin otoman: “Nuk ka dyshim pra, se ‘Kanuni i Lekë Dukagjinit’, kohën e pushtimit otoman në Shqipëri, ka pasë vlerë juridike e është njëfjël për ligjë civile detyruese nder male të Mbishkodrës e në Dukagjin”.

Atë Bernardin Palaj thekson se “Asnjë fjalë e kanunit nuk e përcakton personalitetin e shqyptarit aq fëll e aq dukëshem sa fjala miku i shpís. Nji dritore kjo neper të cillen na shofim se gjithshka ka shqyptari má perzemer, jetë pasuni, gjiye, nderë, besë e burrní brez mbas brezit, të gjitha ja falë mikut qi i rá te dera e shpís. Ma i madhi shnjertzim me kënë mikprém”. Ky njohës dhe studiuues i shquar i të drejtës zakonore arbërore – shqiptare jep rreth kësaj një shembull të qenësishëm: “Nëpër Dukagjin shifet fisi i tanë tuj rrá nder armë per të rrethuem njerin qi i preu mikun shoqit, e grát me una zjarmit në dorë neper flakë të pushkëve tuj msy ngujimet per me djegë per se gjalli gjaksin qi së gjejt me i rá në dorë të fisit tuj shtrud pengun e kanunit per mik të prém ja pse kishte vrá njerin në besë të gjás e të çobanit. Ktu muejte njeri me e pádjelmín e fisit tuj shtí zjarmin gjiyeve e gján e gjallë tuj e shperdá si plaçkë neper fis, ndersa tarabakët ngrehshin shlorë e trupa zhag neper arë të mjelluna, kush pré pemët e buta e kush shem muret e arëve t’atij qi guxon me i pré mikun kuej, per me çue në vend kanunin qi thotë: Kush vret njerin para vedit e në besë të shoqit ase në besë të gjás e të çobanit, i djegun e i pjekun e i qitun jashta fisit e toka djerr per pesmbdhetë vjet...”

Duke bërë fjalë për veçantinë e fisit shqiptar, përkatësisht të popullit tonë, Ernest Koliqi thotë: “Po nuk lidhem krenin e ëm-nit shqiptar me besë, nderë, burrní, mikpritje, d.m.th. me trashigim stërgjyshnuer, sa për vetina tjera, cilat do qofshin, na radhitemi në bisht të kombeve t’Europës”.

Virtytet morale, kulturore e njerëzore të shqiptarit, që dëshmojnë edhe nëpërmjet mikpritjes, nderimit të jashtëzakonshëm të mikut – mysafirrit për arsye se miku për arbrin – shqiptarin zë vendin e dytë të nderimit, vjen mbas Zotit krijues, siç përcaktohet në KLD: “Shpija e Shqyptarit është e Zotit e e mikut”. Kështu, nëse edhe gjaksi futet në shtëpi është mik: “Po të hini miku në shpi, gjak me të pasë, do t’i thuejsh: ‘Mirë se erdhe!’ dhe ndaj tij duhet të sillet si me të gjithë miqtë e tjerë (shih novelën e Ernest Koliqit me titull “Miku”. Pranimit i mikut – mysafirrit në shtëpi, njëherit nënkupton dhe marrjen e

tij nën mbrojtje dhe për mbrojtjen e të cilit s’kursen as shuarja e gjithë familjes. Në të kundërtën, ajo shtëpi – familje, që nuk i përmbahet kësaj, do të trupërohet, gjë që nënkupton një të keqe më të rëndë se vetë vdekja: “Shqipnia ka zakone të çuditshme. Shtëpia e Uc Lleshit s’kishte njoftë kurrë kori. Kushdo që e kish mësy, kish qënë i sigurt se gëzon proje deri në fikjen e në rrenimin e plotë të saj. Nderi i shtëpisë e zakonet e vëndit rrinin për Ucin përmbi çdo interesë, përmbi çdo urdhën qeverije e përmbi ndiesi e arsye tjetër”.

Duhet thënë se dukuritë e tilla etnike, kulturore e shpirtërore janë të ndërthura midis tyre dhe asnjëra e veçuar nuk e ka vlerën e mirëfilltë.

#### ÇKA DËSHMON GJUHA E KANUNIT TË LEKË DUKAGJINIT?

Kanuni i Lekë Dukagjinit ka një vlerë të shumëfishtë edhe në rrafshin gjuhësor shtjellues e shprehës. Kjo gjë nuk është e rastit për arsye se vetë Gjeçovi, mbledhësi dhe shtjelluesi i tij, shpreh një mendim për shumëçka të qenësishëm për gjuhën. Në veprën e tij “Agimi i qytetit” të botuar në Shkodër më 1910, Gjeçovi shkruan: “[...] shtylla e mësojtove të Shqipnis duhet të jetë gjuha shqipe, pse sa mund të mendohet dielli pa dritë, aq mund të mendohet kombi pa gjuhë” dhe “Si ruën dritën e synit, ashtu ruëje gjuhën t’anne, o vllaa Shqyptaar, delizot e shkrijumas sajë, tuj kënë se, saat’a keesh gjuhën kee me kënë edhe ti vetë”.

Sipas studiuesses së shquar, Agnia Desnickaja, “Shtjefën Gjeçovi ka krye një punë të madhe duke kodifikuar normat ligjore, që kishin ekzistuar më parë vetëm në traditën gojore”, dëshmohet edhe përmes vlerës së KLD në rrafshin gjuhësor shprehës. Sipas saj veçorinë kryesore të gjuhës së Kanunit e përbën alternimi i dukshëm i tri shtresave stilistike:

Një vend të veçantë në tekstin e Gjeçovit zënë formulat e qëndrueshme, të cilat në shumicën e tyre mund të jenë mjaft të vjetra. Ky tip i njësive gjuhësore dallohet me karakterin lakonik, madje në disa raste për së tepërmi lakonik. Duke i goditur situatat tipike në thelbin e tyre, këto shprehje duken shpeshherë shumë të errëta, sepse kuptimi i tyre del në shumë raste i pa zgjeruar e i pashkoqitur në mënyrë logjike. Më duket se errësira orakullore e kuptimeve mund të përbente një element të posaçëm në areolin e rëndësisë rituale, që kishin këto formula. Po jap disa shembuj të formulave që janë lidhur me rite të betimit. «Beja mërr gjan e vet», «Bë, e s’ka pertej», «Beja lan gjaqe» e të tjera. Shtresën e dytë stilistike e përbëjnë pjesët e tekstit (nga ana kuantitative ato janë predominuese), në të cilat jepet interpretimi i formulave dhe paraqiten norma e procedura të së drejtës zakonore në formën e shtjelluar të paragrafëve të veçantë. Për të hartuar këto pjesë të tekstit, që janë me shumë rëndësi nga ana e përmbajtjes juridike të Kanunit, Gjeçovi u përpoq të krijonte prova origjinale të stilit juridik, që ishin të parat në gjuhën shqipe [...]

Dallohet përdorimi i dendur i konstrukteve absolute me rasën emërore, të cilat shërbejnë për ta paraqitur kushtin e veprimit, ashtu edhe përdorimi i infinitiveve të shumta, të grumbulluara brenda një periudhe.

Tipi i tretë stilistik del në përshkrimin e riteve popullore (martesa, zakonet e vdekjes, pritja e mikut etj.).

Në këto përshkrime gjuha e Gjeçovit rrjedh, në një mënyrë, e thjeshtë, me fuqi shprehjeje – është gjuha e prozës popullore [...] Pjesa më e madhe e elementeve leksikore që u përdor për ta formuar terminologjinë e së drejtës zakonore [...] përbëhet prej fjalëve të shqipes me gurrë të vjetër indoevropiane. Këto janë p.sh: dorë, gjak, gisht, plak, burrë, grua, vëlla, be, besë, gja, gur, udhë, mal, zjarm, ujë etj.”. Se KLD është një thesar dhe në rrafshin gjuhësor, ku janë ruajtur disa nga fjalët, shprehjet më të lashta të arbërishtes – shqipes, e dëshmojnë edhe këto mendime të gjuhëtarit tonë të shquar, prof. Albert Riskës, të shfaqura në veprën Shqipja dhe krishterimi (Tiranë 2012):

“Gjurmët e zhvillimeve që ka njohur faza e parë, shekujt I – III, janë shumë të pakta në gjuhën shqipe, megjithatë e rëndësishme është që ato nuk mungojnë. Nga kjo fazë duhet të jenë trashëguar në gjuhën tonë fjalët: bajëm, djall, djemën, dreq, hir, mëshirë, shaje, tym, si edhe toponimi Fterrë.

Mund të përmendim si të kësaj faze edhe disa terma që i kanë përkitur terminologjisë së paganizmit, por që krishterimi i përshtati dhe i bëri pronë të terminologjisë së vet, si: zot, e enjte, e premtë si dhe ndonjë emër shenjtor, si Shën Premti dhe Shën Gjini, ndoshta dhe Shën Mitri. Pjesën më të rëndësishme të terminologjisë së krishterë gjuha shqipe e trashëgon nga faza e dytë. Provë e sigurt për këtë është fakti se këta terma janë të burimit latin. Mund të numërohen rreth shtatëdhjetë terma të tillë, që janë në përdorim të përbashkët, pra edhe për pjesën ortodokse, dhe që duhet të trashëgohen që prej asaj kohe, shekujt IV – VI, si fe, priift, meshë, shpirt, ferr, bekoj, mallkoj, pashkë, kumbar, shenjt, engjëll, kreshmë, ungjill, këndojetj.59”. Sipas profesor Riskës, “Këto të dhëna gjuhësore tregojnë se krishterimi ndër shqiptarët është i trashëguar, pra shqiptarët nuk e kanë përqaftuar krishterimin vetë, po kanë lindur si popull i krishterë”.

Për lashtësinë e KLD dëshmojnë dhe Këngët tona kreshnike, krijesa letrare poetike nga më të qenësishmet e artit letrar gojor të krijuar në gjuhën tonë, që luajtën një rol të madh e të shumëfishtë në rrjedhën e ekzistimit e të pasurimit të njeriut shpirtërisht dhe artistikisht, ku jeta dhe veprimi i trimave mbështetet në rregullat e Kanunit të maleve, që zbatoheshin në veprimet e përditshme, që meriton studim të veçantë.

\*\*\*

Po e mbyll këtë Parathënie me mendimin se sa herë t’i kthehemi dhe të merremi me KLD do të vërejmë diçka më shumë sesa kemi vërejtur gjatë leximit të mëparshëm; do të bindemi edhe më tepër për një tekst shkajshmërisht të hapur dhe kuptimisht shumëor dhe me vlera që i kanë përshkuar dhe do t’i përshkojë kohët.

ANTON NIKË BERISHA  
Prishtinë

# LETËRSIA GREKE NDERON PROF.DR. ZEF GJETA PËR LIBRIN MË TË MIRË TË VITIT PËR SHTETASIT E HUAJ

Një vlerësim dhe nderim i veçantë është fitimi i çmimit të parë për librin “Pyetje të Çuditshme, Përgjigje Interesante” si libri më i mirë i huaj dhe përkthimi me i mirë i vitit 2024 në Greqi, ky çmim i fituar nga biri i Dukagjinit dhe i Shkodrës nderon edhe letërsinë shqiptare. Të flasësh për Prof.Dr.Zef Gjetën duhet një kohë e gjatë. Krijimtaria e tij është e shumtë dhe e larmishme. Përveç një specialist i mirëfillte i shkencës bujqësore në insitutin e Misrit dhe Orizit duke arritur rezultate shumë të larta në fushën e kerkimeve shkencore, ai në mesin e viteve 90’ kur në Shkodër nuk botohej asnjë gazetë apo revistë, për vite me rrallë botoi gazetën e më pas revistën “Humori Shkodran” i cili pati jehonë nga lexuesit në të gjithë Shqipërinë. Zefi ishte ideatori dhe realizuesi i karnavaleve të para pas rënjes së sistemit monist në vitin 1998. Mbështetur nga një grup i përzgjedhur artistësh si organizator dhe regjizor i kësaj veprimtarie. Të flasësh për botimet e shumta në letërsi, publicistikë dhe në fushën akademike, si referate apo sesione shkencore, numri i referimeve si brenda dhe jashtë është i palimituar. Sa i takon botimit të librave, është një koençidencë e bukur sepse numri i botimit të librave të tij përkon nga një libër në dy vite jetë. Suksesi i fundit i arritur në Greqi sfidon shkrimtarë të rrangut më të lartë nga vende të ndryshme të cilët përzgjidhen çdo vit në Athinën fqinje. Është një lajm i gëzuar që me ndihmen e profesorit të Zefit, Vasil Zafirati dhe përkthyesit Kosta Nasto, përpara ish-pedagog në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Tiranë dhe tani përkthyes zyrtar në Greqi, u bë i mundur përkthimi i librit “Pyetje të Çuditshme-Përgjigje Interesante”. Është ndihmesa e Z.Kosta që libri u botua në Athinë. Është hera e parë që njëri nga botimet e Prof. Zefit përkthehet në gjuhë të huaj. Libri në fjalë mori pjesë në një konkurs kombëtar në Greqi duke u vlerësuar me çmimin: “Libri më i mirë i huaj, po ashtu dhe përkthimi më i mirë për vitin 2024 në Greqi”. Ky vlerësim ishte sa i merituar edhe interesant që bëhet nga shteti fqinj. Në vendin tonë nuk është dhënë ndonjë njoftim për librat e botuar me shumicë dhe që janë pëlqyer shumë nga lexuesit, dhe në veçanti ato vëllime që i përkasin humorit. Në vendin tonë librat vlerësohen sipas miqësisë dhe emrave, ky vlerësim është sa subjektiv dhe i pamërituar.

Duhet theksuar se Zef Gjeta nuk është thjesht një akademik dhe pedagog i vlerësuar me një përvojë të pasur dhe me një kontribut të çmuar. Ai nuk është i njohur vetëm nga daljet publike për të dhënë këshilla shkencore për ushqimet bio si dhe këshillat për bimët mjekësore. Ai është një person që gjithnjë manifeston vlera dhe ofron kontribut për komunitetin. Ndërsa suksesi i tij i rrallës vjen nga shteti Helen i tempullit të kulturës dhe mitologjisë, atje

ku lindën orakuj dhe morën qiellin perënditë. Profesori dhe autori i mirënjohur Zef Gjeta ka shënuar një tjetër arritje të madhe në karrierën e tij letrare me librin e mësipërm. Me këtë çmim Zef Gjeta ka arritur më tej “trashëgiminë” e tij si një autor kreativ dhe produktiv. Libri në fjalë përmban 1000 pyetje të çuditshme, përgjigjet e të cilave janë plot humor dhe mendim “jashtë kutisë”. Ideja qendrore e këtij librit është të promovojë mendimin dhe të nxisë të qeshura, duke sjellë kënaqësi dhe reflektim nëpërmes formës të një dialogut të përmbledhur, por shumë të mençur, ku ironia, cinizmi, grotesku dhe e qeshura janë aliazh të kësaj lënde që na thërrret dhe na josh nga leximi dhe përjetimi, mendimi dhe arsyetimi. Në libër mund të gjejmë pyetje që në shikimin e parë ose ndjesinë e parë mund të duken të thjeshta, por përgjigjet e tyre janë plot imagjinatë dhe humor. Për lexuesit po përzgjedhim vetëm disa prej tyre:



Pyetje :Në cilin muaj gratë flasin më pak?

gjinie të autorit është një thesar i humorit, i mendimit krijues dhe i filozofisë së përditshme. Ai është krijuar për ti ofruar lexuesit në mënyrë për të menduar ndryshe duke sfiduar të zakonshmen dhe duke provokuar të qeshurat, shpesh në mënyrë të papritur. Autori Zef Gjeta ka arritur të krijojë një atmosferë të ngrohtë dhe argëtuese ku çdo pyetje dhe përgjigje shërbejnë si një ftesë për reflektim dhe humor.

Një pjesë e rëndësishme e suksesit të këtij librit i detyrohet përkthyesit Kosta Nasto, i cili ka sjellë me mjeshtëri nuancat humoristike dhe stilin unik të autorit Zef Gjeta në gjuhën greke. Përkthimi është vlerësuar lart për ruajtjen e tonit origjinal dhe të ndjeshmërisë kulturore, duke u bërë një urë lidhëse në mes lexuesëve shqipëtarë dhe atyre grek. Fitimi i çmimeve prestigjioze në Greqi konfirmon jo vetëm aftësitë e autorit por edhe fuqinë e letërsisë shqipëtare e cila kalon kufinj të kulturorë duke prekur zemrat e lexuesve të huaj. Ky botim është një dëshmi e qartë se humorit dhe mendimi krijues janë universale dhe

dhe mendjes shqipëtare që nuk njeh kufi dhe sfidon çdo barrierë ideologjike dhe retorikë politike të cilat kërkojnë të qëndrojnë si mure ndarëse në mes kulturave dhe traditave, pasurive shpirtërore dhe integriteteve kulturore, ku diversiteti sjell pasurim dhe përjetim të mënyrës se si dija dhe fuqia krijuese ndërtojnë ura komunikimi dhe bashkëjetojnë në botën e të gjithëve.

Menjëherë pas suksesit të tij, Zefi ka marrë shumë urime, komplimente dhe vlerësime nga personazhe të ndryshme si brenda dhe jashtë kufijve të Shqipëtarisë. Dua të përmend disa nga emrat e atyre që bëjnë komente dhe vlerësime, janë zotërinjtë dhe zonjat: Abdullah Diku, Kozeta Rrapi Llane, Vasil Zafirati, Gjergj Habilaj, Gjesh Kronaj, Admir Doda, Donika Kërcini Kreshpani, Alban Çakalli, Marte Miriaj, Agron Vata, Agron Isufi, Fatmir Harusha, Alma Janka, Tomë Gjoklaj, Erald H.Ismaili, Jurgen Pashuku, Dedë Prendaj, Jani Malo, Gjovalin Progni, Gjergj Nika, Flutura Kalemi, Zef



Përgjigja: Në Shkurt sepse nuk u dalin ditet!

Pyetje: Pse nuk kishte fëmijë Lenini?

Përgjigja: Sepse nuk e duronte shtypjen e njeriut prej njeriut!

Pyetje: Pse mbajnë zezakët rrip të bardhë në pantallona?

Përgjigja: Thjesht për të mbajtur pantallonat, pavarësisht nga ngjyra!

Ky libër krahas disa të tjerëve të kësaj

shkrimtarët shqipëtarë kanë shumë për të ofruar në arenën ndërkombëtare. Autori Zef Gjeta me këtë libër, jo vetëm që ka argëtuar lexuesit por ka treguar se si pyetjet dhe përgjigjet e thjeshta mund të hapin dritare të reja të të menduarit. Suksesi i këtij librit është një tjetër gur i çmuar në kurorën e tij si autor dhe një dhuratë e mirëfilltë për lexuesit anembanë botës. Kjo arritje dëshmon për fuqinë e pendës

Nika, Violanda Beci, Alma Guli Dodmasej, Myzi Nepi Kraja, Brahim Malecaj, Gëezim Pllaha, Liljana Rgallina Beqiri, Myzi Nepi Kraja, Kadri Dushe Ujkaj, Lejla Dibra, Zak Topuzi, Arben Molla, Abdyl Arifaj, Sokol Duro, Aurora Piroviç, Gjensarin Shantoja, Ilir Aliaj, Sokol Koli, Manjola Demiraj, Alfred Haxhari, Dashnor Kraja, Rozi Shehu, Al-Ben Guide Kola, Ilir Mehmeti, Isuf Shehi, Jolanda Hyska,

# NDAHET NGA JETA AGRONOMI I PARË I DUKAGJINIT, MARASH MICI

Duhej të kalonin mbi 6 dekada kur Shuk Radoja me origjinë nga Gimajt e Shalës të diplomohet për agronomi në Itali dhe pas kësaj periudhe do të vinte një tjetër “pasardhës” në këtë profesion, Marash Pjetër Mici nga Pylajt e Shoshit. Lindi me 30 Korrik të vitit 1950 në fshatin Shtoj ku prindërit e tij ishin larguar për një jetë më të beгатë. Rrjell nga një familje me tradita të rralla dukagjinase, trashëgimtar i trungut të Sokol Tonës, përsosur i “Lahutës së Fishtës”, i pasuar nga Bush Delia i veçuar në luftë me malaziasit duke rënë në fushën e betejës. Marashi është vllai i mësuesit të nderuar të viteve të para të pasçlirimit, Mhill Pjeter Mici, i larguar nga jeta në lulen e rinisë, i cili gëzonte respekt të veçantë jo vetëm në Shoshin ku lindi por në të gjithë zonën e Dukagjinit, duke u kujtuar edhe ditët e sotme si mësues shumë pasionant e mbi gjithçka një djalosh me shumë vlera. Marashi sapo përfundon shkollën 8-vjeçare “11 Janari” në Shkodër, i mbështetur me bursë nga shteti në konviktin “Malet Tona” më vonë “Tomë Kola” duke përfunduar me rezultate të shkëlqyera fiton bursë në shkollën e mesme bujqësore në Golem të Kavajës, të cilën e përfundoi me rezultate shumë të larta, duke fituar të drejtën e studimit në Fakultetin e Agronomisë të Insitutit të Lartë Bujqësor në Kamëz. Në këtë insitut ai është specializuar për mbro-

jtjen e bimëve. I etur për dije, pasinant dhe këmbngulës për të arritur rezultate të larta në mësim, studionte në mënyrë permanente. Kujtoj si sot në fillimvitet 70’ tek-



mbyllet në një dhomë i vetmuar në dimrin e acartë apo në verën përvëluese tek kushrinjtë e tij, familja Gjeta në Ajasëm,

tek të cilët gjeti mbështetjen si djali i tyre, nisur nga rrethanat familjare për vetë faktin se i ati i Marashit u largua shpejt nga jeta. Në vitin 1975 pas stazhit, ka mbrojtur diplomën me temë në fushën e mekanizimit bujqësor. Fillimisht emërohet në kooperativën bujqësore të Koplikut i cili ka shërbyer në pozicione të ndryshme drejtuese por kryesisht i përqëndruar në fushën e mbrojtjes së bimëve deri në fundvitin 1985. Nga ky vit deri në vitin 1990 ka punuar si agronom specialist në Bajzë dhe më pas duke treguar aftësitë e tij profesionale, emërohet përsëri në Kopluk duke patronazhuar sektorin e buzës të ujit. Nga fillimi i vitit 1991 për 7 vite me rrallë ka ushtruar aktivitetin si specialist në Drejtorinë e Bujqësisë në Malsinë e Madhe. Nga viti 1997 e në vazhdim ka ushtruar biznesin privat me farmaci bujqësore pranë ish-SMT-së, ku ka spikatur me emrin e tij të mirë për të gjithë fermerët e qarkut të Shkodrës. Është shquar si njëri nga specialistët e bujqësisë e në veçanti për mbrojtjen e bimëve nga më të njohurit në vendin tonë. Marashi është trajnuar në mënyrë të vazhdueshme për ngritjen e tij profesionale në fushën e bujqësisë. Ai gëzonte një respekt të veçantë nga studentët, kolegët të cilët ruajnë respektin më të veçantë për shokun e tyre. Marashi ishte një intelektual i zgjuar, fjalëmbël dhe i komunikueshëm me të gjithë. Kishte

një shpirt human për t’iu gjetuar afër shumëkujt në nevojë. E filloi jetën nga hiçi duke patur suksese të vazhdueshme në jetën e tij. Ai është përzgjedhur si një ndër figurat e shquara të zonës së dukagjinit në librin “Dukagjini” të Prof. Dr. Zef Gjeta. Gjatë karrierës së tij, përveç detyrave të ndryshme shtetërore dhe shoqërore dhe si specialist i fushës, ai spikati si një familjar i përkushtuar dhe si një prind model. Së bashku me bashkëshortem, Lenën, rritën dhe edukuan një trio djemsh model për brezin e sotëm. Djali i madh, Marleni ka mbaruar studimet dhe punon si financier duke krijuar një profil të spikatur. Djali i dytë, Margeni, ka mbaruar inxhinierinë kompjuterike i vlerësuar në punën e tij për devotshmërinë dhe profesionalizmin. Ndërsa djali i tretë, Marvisi, ka mbaruar degën e stomatologjisë duke ushtruar profesionin e mjekut-stomatolog.

Kur kishte shumeçka për të dhënë, u largua nga jeta papritmas nga një aksident për të lënë mbrapa një emër të mirë nga të gjithë ata që e njohën dhe e respektuan. Rrugëtimin drejt jetës së pasosur e mendonim shumë më të largët. Ishte një përcjellje me një ceremoni mortore të maturuar dhe të drejtuar nga rrethi i tij familjar, në çdo detaj siç e meritonte vetë ai. Si një person me lidhje familjare i shpreh ngushëllimet familjarëve dhe të gjithë të afërmëve dhe rrethit të tij shoqëror.

I përjetshëm qoftë kujtimi i tij.

**MARK BOBNAJ**  
Mjek-Stomatolog, Studiues

Kastriot Faci, Ornela Memushi, Myslim Osmani, Ndue Kola, Balë Vuksani, Ndue Sana, Merita Jubani Garo, Rozi Shehu, Lulash Ara, Musa Kurtulaj, Ajet Ahmeti, Kosta Raka, Elizabeta Susaj, Liljana Xhixha Gruda, Rrustem Strugaj, Eleni Sarani Metohu, Mirela Pepa Prendushi, Adi Bala Dafku, Ali Laçaj, Gani Zogaj, Marjana Kurti, Klodi Taçi, Mirela Lubonja, Fran Rushaj, Agron Isufi, Enea Linda, Lucë Balaj, Ferid Kola, Trifon Kerbizi, Zef Fiku, Vera Pranvera, Xhelal Shutu, Marte Toplana, Nazmi Kajoshaj, Isak Tema, Pashk Matoshi, Angjelin Vasa, Prek Uka, Sytki Ndrecaj, Ded Qokaj, Arben Trenova, Roland Toma, Teuta Adhamidhi, Gjovalin Kolombi, Lina Vata, Përparim Kabo, Ilir Nicko, Paokë Kalaj, Çesk Prebibaj, Agron Qukaj, Yllka Gjermani, Ali Deliu, Vlbona Binaku Radoja, Valentin Gocaj, Stilian Apostoli, Halim Gjana, Skender Strica, Artan Nano, Robert Pavaci, Frederik Gjoni, Ndue Buraku, Leli Toma, Merita Meçaj, Xhavit Sula, Sofie Spahi. Mendova të veçoj pak nga komentet:

Edmond Kaceli shprehet: Të mos vlerësohesh në vendin tënd dhe të vlerësojnë në vendin e huaj! Ky është paradoksi më i madh i shoqërisë shqiptare! Në shqipëri gjithçka, edhe bota e librit ku pak

kush lexon, është shndërruar në një “qoke” krejt si “like” e rrjetet sociale! Gëzohem për suksesin tënd të merituar e shpresoj që një ditë të vlerësohesh siç duhet dhe e meriton edhe në Shqipëri.

Marash Mirashi shprehet: Një lajm kaq i bukur që më gëzon shumë i dashur mik i kahershëm e i gjithëhershëm Zef Gjeta! Kurorëzim mëse i merituar, duke patur parasysh gjithë kolonën e botimeve tuaja të shumta në letërsi, publicistikë dhe në fushën akademike. Satirat tuaja veçanërisht i bëjnë nder bibliotekës shqipe. U pasoftë ky çmim edhe me çmime të tjera në mëmëdheun tonë! Urime të përzemërta dhe për miqtë që e mundësuan botimin e këtij libri në gjuhën greke.

Ali Lleshi shprehet: Urimet më të mira Zef Gjeta! Me të vërtetë ju e meritoni jo vetëm se je një krijues brilant dhe studiues tepër i zellshëm por mbi të gjitha një njeri i shkëlqyer! Shumë urime edhe për çmimin tepër të merituar dhe prestigjioz.

Muhamet Shala shprehet: Shumë përshëndetje ish nxënësi im Zef Djali! Gëzohem pa masë për këtë vlerësim e botim që i bëhet librit tuaj në shtetin e huaj, në Greqi! Mos u habit dhe mos u shqetëso sepse për punën tuaj të suksesshme, botimin e përkthimit e ndonjë prej panajer-

eve tuaja e mesa di unë nuk janë pak por mbi 30. Ata që komandojnë kulturën tonë nuk gjejnë kohë e mundësi për të vlerësuar objektivisht realitetin. Unë dua të them “ma paçin faqen e bardhë” thona na në Shkoder i dashuri Zef.

Paulin Shoshi shprehet: Zefi, kam kënaqësinë për këtë lajm të gëzueshëm i cili më entuziazmon. Ky vlerësim tregon qartë se kush je dhe ku je si nivel. Të përgëzoj dhe ndihem krenar për ty o miku im.

Linda Shmilli shprehet: Urimet më të mira Zef Gjeta! Mos u rrit mendjen për mosvlerësimin sa duhet të veprave tuaja në Shqipëri. Ty t’ka vlerësuar vetë Zoti që të ka pajisur me aq dhunti e talente sa nuk numërohen dot. Paç gjithmonë suksese!

Besnik Tota shprehet: Bravo, urime, përgëzime o Zef Gjeta. Lart e më lart...! e ka thanë Besnik Çinari në një episod: “Po na vlerësojnë jashtë por spo na njohin merna”.

Ruzhdi Koni shprehet: Urime Prof. Zefi! Meriton rrespekt edhe si personaltet për veprën tënde. Natyrisht në të fushës së agrikulturës krenohemi me ju dhe me Prof. Vasilin si pjesë e familjes sonë!

Bashkim Ngjeci, shprehet: Urimet më të mira dhe vlerësim për çmimin, si li-

bri më i mirë i huaj! Kam përshtypjen se qefmbetja për vlerësimet e këtushme ka një qëllim e objektiv krejt tjetër nga se ju shpreheni, “që ju të mos ndaloni pendën dhe përkushtimin për të botuar e nxjerrë në dritë sa më shumë të jetë e mundur botime me vlerë.

Mark Bobnaj shprehet: Përgëzime për suksesin e arritur nipi ynë! Gjej rastin të “përgëzoj” edhe njerëzit jokopentë që drejtojnë letërsinë dhe artin për mediokritetin e tyre në fushat përkatëse ndër dekada. Ky rast le tu shërbejë për vlerësimet me objektivitet në të ardhmen.

Është momenti të falenderoj në emër të të gjithëve autorin Zef Gjeta për librin fitues të këtij çmimi ndërkombëtar kaq prestigjioz, duke i uruar vazhdimësi suksesi në të ardhmen krijimtarisë së tij letrare dhe shkencore!

**MARK BOBNAJ**  
Mjek-Stomatolog, Studiues,  
Janar 2025

# UDHËTIMI APOSTOLIK I SHENJTËRISË SË TIJ FRANÇESKU NË EMIRATET E BASHKUARA ARABE (3-5 SHKURT 2019)

DOKUMENTI MBI – VËLLAZËRINË NJERËZORE PËR PAQEN BOTËRORE DHE BASHKËJETESËN E PËRBASHKËT  
PËRKTHEU: NIKOLIN SH. LËMEZHI

## PARATHËNIE

Feja e çon besimtarin që të shohë në tjetrin një vëlla për ta mbështetur dhe për ta dashur. Nga feja në Hyjin, që ka krijuar universin, krijesat dhe të gjitha qeniet njerëzore – të barabartë për nga Mëshira e Tij –, besimtari është i thirrur ta shprehë këtë vëllazëri njerëzore, duke e ruajtur krijimin dhe gjithë universin dhe duke mbështetur çdo person, sidomos më nevojtarët dhe më të varfërit.

Duke u nisur nga kjo vlerë transhendente, në takime të ndryshme ku ka mbizotëruar një atmosferë vëllazërie dhe miqësie, kemi bashkëndarë gëzimet, trishtimet dhe problemet e botës bashkëkohore, në nivelin e progresit shkencor dhe teknik, të arritjeve terapeutike, të erës dixhitale, të mass mediave, të komunikimeve; në nivelin e varfërisë, të luftërave dhe të pikëllimeve të shumë vëllezërve e motrave në vende të ndryshme të botës, për shkak të vrapit drejt armatimeve, të padrejtësive shoqërore, të korrupsionit, të pabarazive, të degradimit moral, të terrorizmit, të diskriminimit, të ekstremizmit dhe të shumë arsyeve të tjera.

Nga këto ballafaqime vëllazërore dhe të sinqerta, që kemi pasur, dhe nga takimi plot me shpresë në një të ardhme të shndritur për të gjitha qeniet njerëzore, ka lindur ideja e këtij »Dokumentit mbi Vëllazërinë njerëzore«. Një dokument i arsyetuar me sinqeritet dhe seriozitet që të jetë një deklaratë e përbashkët me vullnete të mira dhe të drejta, i tillë sa që të ftojë të gjithë personat që mbartin në zemër besimin në Hyjin dhe besimin në vëllazërinë njerëzore të njësohen për të punuar së bashku, gjersa ai të bëhet një udhëheqje për të gjitha breznitë e reja drejt kulturës së respektit të ndërsjellë, në përmbajtjen e hirit të madh hyjnor që i bën vëllezër të gjitha qeniet njerëzore.

## DOKUMENTI

Në emër të Hyjit, që ka krijuar të gjitha qeniet njerëzore të barabarta në të drejta, në detyra dhe në dinjitet, dhe i ka thirrur që të bashkëjetojnë si vëllezër mes tyre, për të populluar tokën dhe për të përhapur në të vlerat e së mirës, të dashurisë e të paqes!

Në emër të frymës së pafajshme njerëzore që Hyji ka ndaluar ta vrasim, duke pohuar se kushdo që vret një person është sikur të kishte vrasur gjithë njerëzimin dhe kushdo që e shpëton një është sikur të kishte shpëtuar njerëzimin mbarë!

Në emër të të varfërve, të të mjerëve, të nevojtarëve dhe të të mënjanuarve që Hyji ka urdhëruar t'i ndihmojmë si një detyrë e kërkuar për të gjithë njerëzit dhe në mënyrë të veçantë çdo njeriu të pasur dhe në gjendje të mirë!

Në emër të jetimëve, të vejushave, të refugjatëve dhe të të mërguarve nga banesat e tyre e nga vendet e tyre; të të gjitha viktimave të luftës, të persekutimeve dhe të padrejtësive; të të dobtëve, të atyre që jetojnë në frikë, të të burgosurve të luftës dhe të të torturuarve në cilëndo pjesë të botës, pa asnjë dallim!

Në emër të popujve që kanë humbur sigurinë, paqen dhe bashkëjetesën e përbashkët, duke u bërë viktimë të shkatërrimeve, të rrënimëve e të luftërave!

Në emër të »vëllazërisë njerëzore« që përfaqon të gjithë njerëzit, i njëson dhe i bën të barabartë!

Në emër të kësaj vëllazërie grisur nga politikat e integralizmit dhe të ndarjes dhe nga sistemet e fitimit të tepruar dhe nga prirjet ideologjike të urryeshme, që manipulojnë veprimet dhe fatet e njerëzve!

Në emër të lirisë, që Hyji ua ka dhuruar të gjitha qenieve njerëzore, duke i krijuar të lira dhe duke i dalluar me të!

Në emër të drejtësisë dhe të mëshirës,

të Perëndimit –, deklarojnë që të përdorin kulturën e dialogut si udhë; bashkëpunimin e përbashkët si drejtim; njohjen e ndërsjellë si metodë dhe kriter!

Ne – besimtarë në Hyjin, në takimin përfundimtar me Të dhe në Gjykimin e Tij –, duke filluar nga përgjegjësia jonë fetare dhe morale, dhe nëpërmjet këtij Dokumenti, i kërkojmë vetes sonë dhe Liderave të botës, drejtuesve të politikës ndërkombëtare dhe të ekonomisë botërore, që të angazhohemi seriozisht për të përhapur kulturën e tolerancës, të bashkëjetesës dhe të paqes; të ndërhyjmë, sa më parë që të jetë e mundur, për të ndaluar derdhjen e gjakut të pafajshëm, e për t'i dhënë fund luftës, konflikteve, degradimit të mjedisit dhe rënies kulturore e morale që bota po jeton aktualisht.

Ju drejtohem intelektualëve, filozofëve, njerëzve të fesë, artistëve, operatorëve të mediave dhe njerëzve të kulturës në çdo pjesë të botës, që të rizbulojnë vlerat e paqes, të drejtësisë, të së mirës, të bukurisë, të vëllazërisë njerëzore dhe të bashkëjetesës së përbashkët, për të konfirmuar rëndësinë e këtyre vlerave si spirancë shpëtimi për të gjithë dhe të përpiqen t'i përhapin kudo.

Kjo Deklaratë, duke nisur nga një refle-

alizmit dhe i filozofive materialistike që hyjnizojnë njeriun dhe vënë vlerat e botës dhe materiale në vend të parimeve të larta dhe transhendente.

Ne, edhe duke duke njohur hapat pozitivë që qytetërimi ynë modern ka kryer në fushat e shkencës, të teknologjisë, të mjekësisë, të industrisë dhe të mirëqenies, në mënyrë të veçantë në Vendet e zhvilluara, nënvizojmë se, së bashku me progreset e tilla historike, të mëdha dhe të çmuara, verifikohet një prishje e etikës, që kushtëzon veprimin ndërkombëtar, dhe një dobësim të vlerave shpirtërore dhe të ndjenjës së përgjegjësive. Gjithë kjo kontribuon në përhapjen e një ndjenje të përgjithshme frustrimi, vetmie dhe dëshpërimi, duke çuar shumë në rënie ose në vorbullën e ekstremizmit ateist dhe agnostik, ose në integralizmin religjioz, në ekstremizmin dhe në fundamentalizmin e verbër, duke bërë kështu që persona të tjerë të dorëzohen në forma varësie dhe vetëshkatërrimi individual e kolektiv.

Historia pohon se ekstremizmi religjioz dhe kombëtar dhe mostolerimi kanë prodhuar në botë, qoftë në Perëndim qoftë në Lindje, atë që do të mund të ishte quajtur sinjalet e një »luftë të tretë botërore me pjesë«, sinjale që, në pjesë të ndryshme të botës dhe në kushte të ndryshme tragjike, kanë filluar të shfaqin fytyrën e tyre mizore; situata për të cilat nuk njihet me saktësi sa viktimë, vejusha dhe jetimë kanë prodhuar. Përveç kësaj, ka zona të tjera që përgatiten për t'u bërë teatër konfliktesh të reja, ku lindin vatra tensioni dhe grumbullohen armë dhe municione, në një situatë botërore të zotëruar nga pasiguria, nga zhgënjimi dhe nga frika e së ardhmes dhe e kontrolluar nga interesat ekonomike miope.

Pohojmë gjithashtu se krizat e forta politike, padrejtësia dhe mungesa e një shpërndarjeje të drejtë të pasurive natyrore – prej të cilave furnizohet vetëm një pakicë të pasurish, në dëm të shumicës së popujve të tokës – kanë krijuar, dhe vazhdojnë ta bëjnë, sasi të mëdha të sëmurësh, nevojtarësh dhe të vdekurish, duke provokuar kriza vdekjeprurëse prej të cilave janë viktimë vende të ndryshme, pavarësisht pasurive natyrore dhe risurseve të breznive të reja që i karakterizojnë. Përballë krizave të tilla, që bëjnë të vdesin nga uria miliona fëmijë, tashmë të katandisur në skelete njerëzore – për arsye të varfërisë dhe të urisë –, mbretëron një

- vijon në faqen 16 -



themele të begatisë dhe bazë e fesë!

Në emër të të gjithë personave me vullnet të mirë, të pranishëm në çdo cep të tokës!

Në emër të Hyjit dhe të gjithë kësaj, Al-Azhar al-Sharif – me myslimanët e Lindjes e të Perëndimit –, së bashku me Kishën Katolike – me katolikët e Lindjes e

ktim i thellë i realitetit tonë bashkëkohës, duke vlerësuar sukseset e tij dhe duke jetuar dhimbjet e tij, fatkeqësitë e tij dhe gjëmët, beson me ngulm se ndër shkaqet më të rëndësishme të krizës së botës moderne janë një ndërgjegje njerëzore e anestetizuar dhe largimi nga vlerat fetare, për më tepër edhe mbizotërimi i individu-

# PROBLEMET E SOTME TË SHKOLLËS, JANË SA TË VËSHITIRA AQ EDHE EMERGJENTE



FRAN GJOKA

Reformimi i shkollës është një sistem shumëplanësh dhe bashkëpunues i shumë faktorëve e aktorëve, ku japin ndikimin e tyre në forcimin cilësor të arsimit. Realisht sot sistemi që pretendon emrin, nuk po funksionon e për rrjedhojë mekanizmi i drejtimit dhe i menaxhimit subjektiv të arsimit ka ardhur gjithnjë në rënie. Arsimi nuk është një përgjithësi subjektive, që realisht kanë mbetur në letër, por është një projekt inteligjent që kërkon një menaxhim intelektual në rang qarqesh dhe bashkive të vendit.

**Drejtimi i shkollës nuk bëhet as nga militantët dhe as nga mësues të zakonshëm**

Jo kushdo mund të bëhet drejtues arsimi, pavarësisht nga dëshira e mirë e njërit apo tjetrit. E parë në këtë këndvështrim mendojmë se militantizmi, e ka dëmtuar rëndë sistemin arsimor të vendit. Përzgjedhja e kuadrit drejtues të arsimit, i thëncin me konkurs, kanë vepruar, duke emëruar gjithnjë mbi bazën e kriterëve të tjera, si ato nepotike, partiake, e pse jo edhe korruptive e servile, të cilat e kanë kompromentuar rëndë realizimin e reformës, duke krijuar kështu mendimin e gabuar se drejtor shkollë, arsimit rajonal apo vendor mund të bëhet kushdo. Në këtë kuptim, është paradoksale dhe i afrohet një shërbim i keq institucionit të arsimit dhe të ardhmes së tij, ku drejtori, që ka fituar të ashtuquajturin konkurs, ka më pak përvojë e përgatitje shkencore e pedagogjike sesa kolegët e tjerë. Është shkruar e shkruhet, është folur e flitet shumë për drejtimin, për drejtuesit e shkollave. Sa e si përzgjidhet drejtuesi? Sa efektiv e mjeshtëror është ai? Faktet dëshmojnë se konkurset apo opinionet, rekomandimet në emërime janë larg atyre që kërkon realiteti, koha, kërkesat në shërbim të reformimit. S'ka më të çmuar e realist se syri i kolektivit. Përse? Zotësia apo specializimi, posti drejtues efektiv rrezaton në kolektiv. Ai që merr postin e drejtorit a të drejtoreshës ka peshën e malit mbi supe. Pra, trinomi: Sinqeriteti, zotësi, dhe përkushtim, ia kalojnë çdo "konkursi", çdo hamendësimi opinionesh nga lart. "Një shembull në praktikë, - thoshte ideologu i shquar Sami Frashëri, - është më mirë se një mijë fjalë të bukura". Shembulli rrezaton aftësinë, taktin, vlerat, shpirtin krijues dhe nxit, organizon kolektivin pedagogjik. Drejtuesi me grada e konkurse (Sigurisht edhe këto duhen) por që i mungon shembulli i reformës, sinqeritetit e provat e përditshme si veprimtar, kurrsesi

nuk gëzon respektin e trupës pedagogjike. Korrektësia drejtuesit nuk i falet të bjerë në grackën e konformizmit apo të bajraktarizmit. Drita e dijeve rrezaton, kur udhëheq shembull, me kompetencë, si prijës e masovik. Problemet e sotme të shkollës janë sa të vështira aq edhe emergjente. Të bëjnë përshtypje qoftë drejtues të qeverisë, qofshin drejtues shkollash ku flasin "me duhet", "duhet", "edhe duhet"! Koha dhe dukuritë kanë nevojë për veprues reformues, vetëveprues, shëmbëllim në praktikë, takt, durim, e mbi të gjitha masivitet e premtim të punëve me kolegët, me prindërit. Takti i drejtuesit dhe i mësuesit është parësor, ku të shoqëruar me përkushtim e "peshoren" e fjalës, sigurisht të çojnë në arritje. Puna pa zotëruar atë çka e kërkon realiteti e koha ngjan me pemën pa kokrra. Kërkesat e reja kërkojnë përkushtim të ri, vlerësim serioz të dukurive.

**Pesha dhe përgjegjësia e një drejtuesi shkollë është e madhe, ajo kërkon zotësi drejtimi dhe kualifikim të lartë**

Shtrojmë pyetjen: -Sa psikolog është drejtori, po mësuesi? Pesha e rëndë në shërbim të edukimit nuk arrihet me konstatime, me këshilla, por me durim, vepër, e mbi të gjitha me zotërim të punëve të njohjes së kolegëve (vlerave e halleve) të njohjes së nxënësve të kulturës e traditave të familjeve të nxënësve. I ashtuquajturin portal "Mësues për Shqipërinë" është huazuar keq në arsim. Është paradoks i vërtetë praktikimi i kësaj formule famëkeqe për mësuesinë shqiptare, ku fare mirë dihet se në Itali dhe në disa vende të BE bazohet në meritë dhe është vërtetë kuptimplotë.

Për Italinë, mësuesit shkojnë ku ka nevojë vendi, sepse mësuesit motivohen dhe u krijohen kushte optimale për punë e jetesë. E kundërta po ndodh në sistemin tonë arsimor ky portal po shërben si fasadë djallëzore e MAS, DARP, DAVP, ku si pasojë ka sjellë një paligjshmëri të vërtetë, që po i bëhet me emërimet dhe shkarkimet e mësuesve.

Me keqardhje shikojmë aty-këtu liberalizëm të theksuar në veprimtarinë mësimore edukative të punës në shkolla shtetërore, ndryshe po ndodh në disa nga shkollat private, ku zotëron rregulli dhe disiplina në kuota optimale. Kurse në disa nga shkollat publike mungon kërkesa unike e llogarisë ndaj nxënësve dhe informacioni i prindërve për shkelje disiplinore në shkolla. Adoleshenca e sotme është futur rrugës inkriminimit dhe prindërit heshtin apo s'dinë të punojnë me fëmijët në aspektin edukativ.

Me keqardhje dëgjojmë çdo ditë ngjarje makabre të adoleshentëve në rrethinat e shkollës dhe jashtë saj, që po trondit çdo ditë mbarë opinionin publik shqiptar. Me keqardhje vëmë re, MAS nuk ka impenjimin e duhur për të parë nëse është e domosdoshme një ndërhyrje e tillë në reformimin e kuadrit drejtues në të gjitha hallkat e sistemit para universitar. Kemi

plot raste të vërtetuara, për veprime abuzive, nga media e shkruar dhe auovizive. Me këtë sistem arsimor çdo ditë në rënie, shtrohet detyrë të përzgjedhim drejtues që kanë guxim intelektual, persona jopolitik dhe që janë kundër konformizmit, të jenë racional dhe të realizojnë dy synime të mëdha: Aktin e pastrimit, dhe të ndryshimit, duke filluar nga drejtimi në shkollë, në rang rajonal dhe vendor të vendit. E themi këtë, se kemi drejtues rajonal dhe vendor që kanë hyrë në vitin e tetë apo të dhjetë të punës, pa kontribuar në asnjë fushë të kërkimit shkencor, pedagogjik e didaktik, në një kohë që kemi plot breza të tërë të rinjsh që janë të shkëlqyer në një apo dy mastra shkencorë apo profesionalë, e që mbahen larg institucionit të arsimit rajonal apo vendor të vendit.

**Administrata e arsimit ka shumë shkresa burokratike dhe pak zgjidhje konkrete**

Me keqardhje shikojmë një administratë të fryrë rajonale dhe vendore, që fatkeqësisht janë kthyer vetëm në zbatues të shkresave dhe vendimeve burokratike që vijnë nga lart dhe që në shkolla pak ose aspak shkojnë. Çdo gjë ka mbetur në besimin absolut të drejtuesve të shkollave, ndërsa me mësuesit dhe vështirësitë e punës së tij me nxënësit nuk merret askush. Fatkeqësisht, u hoq kontrolli inspektoratit rajonal të arsimit. Mendoj se ishte një gabim i rëndë i MAS. Shpresoj të rikthehet, sepse drejtuesit dhe mësuesit në shkolla do të jenë më impenjativ për punën e tyre mësimore-edukative.

Sado të flasim e të shkruajmë, përsëri është politika që ka ndërhyrë dhe ka shkatërruar sistemin arsimor, janë simpatizantët drejtues të arsimit që po e mbajnë gjallë politikën e ditës në arsim. Është folur dhe shkruar për ngarkesën mësimore të mësuesit dhe të nxënësit, për peshën e rëndë të çantës, për Alertekestin që është kritikuar gjithnjë dhe Ministria hesht, për librat e mbingarkuara me materiale pa vlerë, për asimilimin e vështirë të marrjes e njohurive, për uljen e numrit të nxënësve në klasa etj. Konkretisht çfarë po ndodh në tekstet shkollorë? Ku janë vlerat intelektuale e kombëtare? Po bota akademike pse hesht përballë këtyre fakteve që na shqetësojnë? Vazhdojmë të kopjojmë librat e vendeve të tjera të botës, kur kemi programet tona mësimore edukative, të cilat mund të përshtaten fare mirë, duke ruajtur kulturën, pavarësinë edhe mbi të gjitha vlerat tona të çmuara kombëtare.

Për të shkruar në rrënjët e problemit, duhet të kthehemi tek qëllimi themelor i mungesës totale të menaxhimit intelektual të arsimit, që me keqardhje themi se askush nga drejtuesit qendror apo vendor s'kanë marrë ende seriozisht dhe të kemi një përgjigje urgjente se si duhet ndërhyrë, drejtuar dhe administruar në të ardhmen e shpejtë arsimit ynë kombëtar. Ajo që e vyshk shpirtin e arsimit, pa mëdyshje

është politika. Përse? Sloganet boshe, formalizmi, këshillat falsë, fjalori i shthurur e amoral i politikanëve, grindjet e shpifjet e tyre ndaj njeri-tjetrit, ashtu sikurse tik-toku e celulari bëjnë të kundërtën e edukimit, e shfuqizojnë rolin e mësuesit e të drejtimit të shkollës. Fëmijët sot kanë ngarkesë të madhe jashtë librave e punëve të mira në klasë a shkollë. Përse? Shumicën i tërheq shembulli negativ. Pra, sistemi i arsimit kurrsesi nuk përparon pa gjetur "çelësin e shpirtit" të arsimit. Çelësi i shpirtit është dëshmia e suksesit, është shtylla kurrizore e sistemit të arsimit.

Faktet dëshmojnë se çelësi i drejtimit është ndryshkur, ka nevojë të gërshetohet me blerimin e shpirtit në drejtim të dijeve e të edukimit. Sa lexojnë e zbatojnë drejtuesit? Sa fryte u jep ecuria konkrete në shkollë e komunitet? A kanë shkalën e vërtetë të një vatre komunitare: me veprimtari, me dhomë muze, me histori shkollë?! Çdo ditë mbetet që drejtuesit të mbajnë pasqyrë për ecurinë reformuese, mësimore-edukative.

Shërimi më i çmuar i kombit e i brezave është që me zell e veprime konkrete të reflektojnë shpirti i sistemit bashkëkohor të arsimit. Flitet e shkruhet për seminare, për reformim, për evidenca e planëzime, për rolin edukativ të nxënësve. Sigurisht kjo është anë e mirë dhe vlen, por nëse vlerësojmë frytet e gjendjen konkrete e aktuale të arsimit duken sheshazi e në plotësi boshllëku edukativ, formalizmi e burokratizmi pedagogjik janë të veshur me qyrk demokratik. Përse? Nën petkun e lirisë, të lidhjeve të ngushta me nxënësit e të mbajtjes afër mësuesve frenohet, tuletet bien në formalizëm, kurse drejtuesi bie në konformizëm. Pra, nxënësi di të respektohet, vlerësohet, por kurrsesi nuk duhet heshtur e tulatur para dukurive negative, para shfaqjeve të pahijshme, para përsëritjes së gabimeve. Autoriteti, lidhjet formale, mos guximi për t'u përballur e vyshkin, e thajnë autoritetin dhe shpirtin e arsimit. Një i moshuar na tha: "Arsimi në ditët tona është gati si lisi pa lena e si i sëmuri që i dhemb zemra. Lisi pa lena shpejt mbetet i tharë, i sëmuri rëndë nga zemra shpejt ndërron jetë".

Zotësia e mjeshtëria pedagogjike e psikologjike e drejtuesit të shkollës dhe e mësuesit matet me punë që bën e frytet që korr me të vështirat, me tipat që sjellin probleme në shkollë në komunitet. Sigurisht që mendja e nxënësit është nën sulmin e internetit, tik-tokut e të plot dukurive negative që shfaqen në ekrane me fjalorin bajat e tepër vulgar, të mjaft politikanëve, deputetëve, analistëve që grinden etj. Sistemi arsimor pretendon emrin, po shpirti i arsimit? Ky shpirt merr jetë nga drejtimi korrekt, krijues e i guximshëm, nga vetëmohimi e vetë kualifikimi, në proces në punën frytdhënëse mësimore

- vijon nga faqja 14 -

heshtje ndërkombëtare e papranueshme.

Është në pah lidhur me këtë se sa thelbësore është familja, si bërthamë themelore e shoqërisë dhe e njerëzimit, për të nxjerrë në dritë disa bij, për t'u kujdesur për ta, për t'i edukuar, për t'u dhënë atyre një moral të fortë dhe një mbrojtje familjare. Sulmimi i institucionit familjar, duke e përçmuar ose duke dyshuar për rëndësinë e rolit të tij, përbën një prej të këqijave më të rrezikshme të epokës sonë.

Dëshmojmë edhe rëndësinë e rizgjimit të ndjenjës fetare dhe të rëndësisë për ta gjallëruar në zemrat e brezëve të reja, nëpërmjet edukimit të shëndoshë dhe përputhjes me vlerat morale dhe me mësimet e drejta fetare, për të përballuar prirjet individualistike, egoistike, konfliktuale, radikalizmin dhe ekstremizmin e verbër në të gjitha format dhe manifestimet e tij.

Objektivi i parë dhe më i rëndësishëm i feve është ai për të besuar në Hyjin, për Ta nderuar dhe për të thirrur të gjithë njerëzit që të besojnë se ky univers varet nga një Hyj që e qeveris, është Krijuesi që na ka formuar me Urtinë e Tij hyjnore dhe na ka dhënë dhuratën e jetës për ta ruajtur. Një dhuratë që askush nuk ka të drejtë ta heqë, ta kërcënojë ose ta manipulojë sipas kënaqësisë së vet, madje, të gjithë duhet ta ruajnë një dhuratë të tillë të jetës nga fillimi i saj deri në vdekjen e saj natyrore. Prandaj, dënojmë të gjitha praktikatat që kërcënojnë jetën si genocidet, aktet terroristike, dyndjet e detyruara, trafikun e organeve njerëzore, abortet dhe eutanazinë dhe politikatat që mbështesin gjithë këtë.

Gjithashtu deklarojmë – me vendosmëri – se fetë nuk nxisin kurrë për luftë dhe nuk nxisin ndjenja urrejtjeje, armiqësie, ekstremizmi, as nuk ftojnë ndaj dhunës apo ndaj derdhjes së gjakut. Këto fatkeqësi janë fryt i shtrembërimit të mësimet fetare, të përdorimit politik të feve dhe edhe të interpretimeve të grupeve të njerëzve të fesë që kanë abuzuar – në disa faza të historisë – me ndikimin e ndjenjës fetare në zemrat e njerëzve për t'i çuar në kryerjen e asaj që nuk ka aspak të bëjë me të vërtetën e fesë, për të realizuar qëllime politike dhe ekonomike që janë tokësorë dhe miopë. Për këtë ne iu kërkohet të gjithëve të pushojnë së instrumentalizuarit fetë për t'i nxitur ndaj urrejtjes, ndaj dhunës, ndaj ekstremizmit dhe fanatizmit të verbër e të pushojnë së përdoruri emrin e Hyjit për të justifikuar veprat e vrasjeve, të mërgimit, të terrorizmit e të shtypjes. E kërkohet për besimin tonë të përbashkët në Hyjin, që nuk i ka krijuar njerëzit që të vriten apo që të ndeshen mes tyre dhe as për t'u torturuar apo përvuajtëruar në jetën e tyre e në ekzistencën e tyre. Në fakt, Hyji, I Gjithëpushtetshmi, nuk ka nevojë që të jetë i mbrojtur nga askush dhe nuk do që emri i Tij të jetë i përdorur për të terrorizuar njerëzit.

Ky Dokument, në pajtim me Doku-

mentet Ndërkombëtare të mëpërparshme, që kanë nënvizuar rëndësinë e rolit të feve në ndërtimin e paqes botërore, dëshmon si në vijim:

- Bindjen e fortë se mësimet e vërteta të feve ftojnë që të qëndrojmë të kapur me vlerat e paqes; të mbështesim vlerat e njohjes së ndërsjellë, të vëllazratel-lazërisë njerëzore dhe të bashkëjetesës së përbashkët; të rivendoset dija, drejtësia dhe dashuria dhe të rizgohet ndjenja e religjiozitetit mes të rinjve, për të mbrojtur brezat e rinj nga zotërimi i mendimit materialist, nga rreziku i politikave të lakmisë së fitimit të tepruar dhe të indiferencës, të bazuara mbi ligjin e forcës dhe jo mbi forcën e ligjit.

- Liria është e drejta e çdo personi: secili gëzon lirinë e besimit, të mendimit, të shprehjes dhe të veprimt. Pluralizmi dhe ndryshueshmëria e fesë, e ngjyrës, e seksit, e racës dhe e gjuhës janë një vullnet i urtë hyjnor, me të cilin Hyji ka krijuar qeniet njerëzore. Kjo Urti hyjnore është origjina nga ku vjen e drejta për lirinë e besimit e për lirinë për të qenë ndryshe. Për këtë dënohet fakti për të detyruar njerëzit që të bashkohen me njëfarë feje apo me njëfarë kulture, ashtu edhe imponimi i një stili qytetërimi që të tjerët nuk e pranojnë.

- Drejtësia e bazuar mbi mëshirën është udha për ta përshkuar që të arrihet një jetë dinjitoze për të cilën ka të drejtë çdo qenie njerëzore.

- Dialogu, mirëkuptimi, përhapja e kulturës së tolerancës, e pranimt të tjetrit dhe e bashkëjetesës mes qenieve njerëzore do të mund të kontribuonte në mënyrë të dukshme për të zvogëluar shumë probleme ekonomike, shoqërore, politike dhe mjedisore që sulmojnë pjesën më të madhe të gjinisë njerëzore.

- Dialogu mes besimtarëve do të thotë të takohesh në hapësirën e pakufi të vlerave shpirtërore, njerëzore dhe shoqërore të përbashkëta, e të investohet kjo në përhapjen e virtyteve më të larta morale, të nxitura nga fetë; do të thotë edhe të shmangim diskutime të kota.

- Mbrojtja e vendeve të kultit – tempuj, kisha dhe xhami – është një detyrë e garantuar nga fetë, nga vlerat njerëzore, nga ligjet dhe nga konventat ndërkombëtare. Çdo tentativë për të sulmuar vendet e kultit apo për t'i kërcënuar nëpërmjet atentateve apo shpërthimeve ose shkatërrimeve është një devijim nga mësimet e feve, por edhe një dhunim i qartë i të drejtës ndërkombëtare.

- Terrorizmi i urryer që kërcënon sigurinë e personave, qoftë në Lindje qoftë në Perëndim, qoftë në Veri qoftë në Jug, duke shpërndarë panik, terror dhe pesimizëm nuk vjen nga feja – megjithëse terroristët e instrumentalizojnë – por vjen nga interpretime të grumbulluara të gabuara të teksteve fetare, nga politikatat e urisë, të varfërisë, të padrejtësisë, të shtypjes, të arrogancës; për këtë është e nevojshme të ndërpritet mbështetja e lëvizjeve ter-

roriste nëpërmjet furnizimit me para, me armë, me plane apo justifikime dhe edhe mbulimi mediatic, dhe të konsiderohen të gjitha këto si krime ndërkombëtare që kërcënojnë sigurinë dhe paqen botërore. Nevojitet të dënojmë një terrorizëm të tillë në të gjitha format dhe shfaqjet e tij.

- Koncepti i qytetarisë bazohet mbi barazinë e të drejtave dhe të detyrave nën hijen e të cilit të gjithë gëzojnë drejtësinë. Për këtë është e nevojshme të angazhohemi për të vendosur në shoqëritë tona konceptin e qytetarisë së plotë e të mohojmë përdorimin diskriminues të termit pakicë, që mbart në vete farat e të ndierit të izoluar dhe të inferioritetit; ai përgatit terrenin ndaj armiqësisë dhe përçarjes dhe iu heq arritjet dhe të drejtat fetare e civile të disa qytetarëve duke i diskriminuar.

- Raporti mes Perëndimit dhe Lindjes është një nevojë e ndërsjellë e padiskutueshme, që nuk mund të zëvendësohet as nuk mund të lihet pas dore, në mënyrë që të dy të mund të pasurohen në mënyrë të ndërsjellë me qytetërimin e tjetrit, nëpërmjet shkëmbimit dhe dialogut të kulturave. Perëndimi do të mund të gjente në qytetërimin e Lindjes masa për disa sëmundje të tij shpirtërore e fetare të shkaktuara nga sundimi i materializmit. Dhe Lindja do të mund të gjente në qytetërimin e Perëndimit shumë elemente që mund ta ndihmojnë që të shpëtojnë nga dobësia, nga ndarja, nga konflikti dhe nga rënia shkencore, teknike dhe kulturore. Është e rëndësishme t'u japësh vëmendje ndryshimeve fetare, kulturore dhe historike që janë një përbërës thelbësor në formimin e personalitetit, të kulturës dhe të qytetërimt lindor; dhe është e rëndësishme të përforcohen të drejtat njerëzore të përgjithshme dhe të përbashkëta, që të kontribuohet në garantimin e një jete dinjitoze për të gjithë njerëzit në Lindje dhe në Perëndim, duke iu shmangur përdorimit të politikës me dy masa.

- Është një nevojë e domosdoshme të njihet e drejta e gruas për mësim, për punë, për të ushtruar të drejtat e saj politike. Përveç kësaj, duhet të punohet për ta liruar nga presionet historike dhe shoqërore që janë kundër parimeve të besimit vetjak dhe të dinjitetit vetjak. Është e nevojshme edhe të mbrohet nga shfrytëzimi seksual dhe nga të trajtuarit si mall ose si mjet kënaqësie apo përfitimi ekonomik. Për këtë duhet të ndalohen të gjitha praktikatat çnjerëzore dhe zakonet vulgare që e përvuajtërojnë dinjitetin e gruas e të punohet për të modifikuar ligjet që u ndalojnë grave të gëzojnë plotësisht të drejtat e veta.

- Mbrojtja e të drejtave themelore të fëmijëve për t'u rritur në një mjedis familjar, për t'u ushqyer, për t'u edukuar dhe për asistencë është një detyrë e familjes dhe e shoqërisë. Të drejta të tilla duhet të jenë të garantuara e të mbrojtura, që të mos mungojnë dhe të mos u mohohen asnjë fëmije në asnjë pjesë të botës. Nevojitet të dënohet çdo praktikë që dhunon

dinjitetin e fëmijëve ose të drejtat e tyre. Është gjithashtu e rëndësishme të vigjilohet kundër rreziqeve ndaj të cilave ata janë të ekspozuar – në mënyrë të veçantë në ambientin dixhital – dhe të konsiderohet si krim trafiku i pafajësisë së tyre dhe çdo dhunim i fëmijërisë së tyre.

- Mbrojtja e të drejtave të të moshuarve, e të dobëve, e të paaftëve dhe i të shtypurve është një nevojë fetare dhe sociale që duhet garantuar dhe mbrojtur nëpërmjet legjislacioneve të forta dhe zbatimit të konventave ndërkombëtare lidhur me këtë.

Për këtë qëllim, Kisha Katolike dhe al-Azhar, nëpërmjet bashkëpunimit të përbashkët, shpallin dhe premtojnë se do ta çojnë këtë Dokument tek Autoritetet, tek Liderat që kanë ndikim, tek njerëzit e besimit në të gjithë botën, tek organizatat rajonale dhe ndërkombëtare kompetentë, tek organizatat e shoqërisë civile, tek institucionet fetare dhe liderat e mendimit; dhe të angazhohemi në përhapjen e parimeve të kësaj Deklarate në të gjitha nivelet rajonale e ndërkombëtare, duke nxitur që të përkthehen në politika, vendime, tekste legjislativë, programe studimi dhe materiale komunikimi.

Al-Azhar dhe Kisha Katolike kërkohet që ky Dokument të bëhet objekt kërkimi dhe reflektimi në të gjitha shkollat, në universitete dhe në institutet e edukimit e të formimit, me qëllim që të kontribuohet për të krijuar breza të rinj që të sjellin të mirën dhe paqen dhe të mbrojnë kudo të drejtën e të shtypurve dhe të prapambeturve.

Në përfundim urojmë që: kjo Deklaratë të jetë një ftesë për pajtimin dhe vëllazërinë midis të gjithë besimtarëve, madje mes besimtarëve dhe jobesimtarëve, dhe mes të gjithë personave me vullnet të mirë;

të jetë një thirrje për çdo ndërgjegje të gjallë që të kundërshtojë dhunën rravguese dhe ekstremizmin e verbër; thirrje për atë që do vlerat e tolerancës dhe të vëllazërisë, të premtuara dhe të inkurajuara nga fetë;

të jetë një dëshmi e madhësisë së besimit në Hyjin që njëson zemrat e ndara dhe lartëson shpirtin njerëzor;

të jetë një simbol i përfaqimit mes Lindjes dhe Perëndimit, mes Veriut dhe Jugut e mes të gjithë atyre që besojnë se Hyji na ka krijuar për të na njohur, për të bashkëpunuar mes nesh e për të jetuar si vëllezër që duhen.

Kjo është ajo që shpresojmë dhe përpiqemi të realizojmë, me qëllim që të arrijmë një paqe universale nga e cila të gëzojnë të gjithë njerëzit në këtë jetë.

Abu Dhabi, 4 shkurt 2019

Shenjtëria e Tij

PAPA FRANCESKU

Imami i Madh i Al-Azhar

AHMAD AL-TAYYEB

## REDAKSIA

**Kryeredaktore: Klodjana Serraj**  
Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri, Suela Ndoja, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

**MUNDËSUAN BOTIMIN  
VËLLEZËRIT, ZEF,  
KRISTJAN E KLADIO  
PALI, ME BANIM NE  
KOMUNEN CUNEO,  
ITALI**

